



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 10(424)

TETOR 2023

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANI0BVL.ORG

## 80-VJETORI



Brigada i dha atdheut jetën e 256 luftëtarëve të cilët kujtohen e nderohen në breza

**KUR BRIGADA E 3-TË QËLLOI ME TOP ASAMBLËNË TRADHTARE**

**Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj**

FAQE 2

## SESIONI SHKENCOR

**Ahmet Cami – Biografi e shkruar me gjak si pjesëmarrës i dy luftrave botërore**



FAQE 8

## MONOGRAFIA

**BIBË KAZA: GJIN SHURBI, ETALONI NËPUNËSIT TË ADHURUAR**



Nga Halil RAMA-Mjeshtër i Madh FAQE 14

*Hapa konkretë për realizim me sukses të objektivave të parashikuara në planin afatshkurtër dhe afatmesëm*

# SHBA-SHQIPËRI, KONSULTIME DYPALËSHE NË FUSHËN E MBROJTJES

## EDITORIAL

**NUK MUND TË NDËRTOJMË TË ARDHMEN NËSE NUK NDEROJMË TË KALUARËN**

Nga Maksim Vinçani, Nënkrjetar i OBVL

Mbas një korespondence midis nesh, arritëm të njihemi nga afër me Z.Ramiz Qeriqi ose Luani - pseudonimi i tij gjatë Luftës së UÇK. Ishte kënaqësi e veçantë të bisedoje me Luanin, ish - komandantin legjendar të Batalionit të Dytë heroik të UÇK-së, "Ruzhdi Salihu". me këtë njeri kaq të thjeshtë dhe modest, njëherësh një legjendë e vërtetë. Atë natë kur u njohëm nga afër, i ftuar në shtëpinë time në Elbasan, pothuajse e gdhimë duke folur, ku mësova nga goja e tij për shumë e shumë gjëra që më lanë përshtypje të thella...

VIJON NE FAQEN 16



• *Ministri Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen e pakushtëzuar të SHBA ndaj Shqipërisë. Sipas ministrit Peleshi, bashkëpunimi i shkëlqyer që karakterizon marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve është përkthyer në një kontribut të vyer në përpjekjet e vendit tonë për të qenë eksportues të sigurisë, jo vetëm në rajon, por si një partner i besueshëm i SHBA-ve dhe NATO*

FAQE 3

## OPINION

**TË MOS E PENGOJMË E DEKURAJOJMË ALBININ PËR HIR TË TË MËDHENJVE**

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 5

## ANALIZA

**GJASHTË BETEJAT E HUMBURA DHE FUNDI TURPËRUES I LUFTËS SË RUSISË - PUTINISTE"**

Gjeneral © Piro Ahmetaj\*

FAQE 4

## ESSE

**Letra e pa dërguar**

Dëshmori Cane Shaqo Bega

Kalojnë vite, kalojnë edhe shekuj e kujtimi për dëshmorët mbetet i freskët në mendjet tona...

Nga Neki Çako



FAQE 6

**Kur do të marrë fund terrorizmi?**

Mimoza DAJÇI

FAQE 15

## TRADITA

**NË KËRKIM TË VESHJES SË BUKUR KABASHISHT**

Xhemal MEÇI

Studiues & " Mjeshtër i Madh"

FAQE 7

## 79-VJETORI

**HISTORIA E LAVDISHME E BRIGADAVE TË 9-TË DHE 24-T S**

FAQE 10, 11

## HISTORIA

**GJAK SHQIPTARI RRËZË BEUNIT NË FSHATIN VAJZË**

Prof. Asoc. Zaho GOLEMI

Irfan BIRBILAJ

Trifon GOLEMI

FAQE 12

## AKTUALITET

**BASHKËPUNIM SHEMBULLOR MES VETERANËVE TË LANÇ DHE INTELEKTUALËVE TË GJAKOVËS**

Bashkim HISARI

FAQE 13

## 80-VJETORI

*Brigada i dha atdheut jetën e 256 luftëtarëve të cilët kujtohen e nderohen në breza*

# KUR BRIGADA E 3-të QËLLOI ME TOP ASAMBLËNË TRADHTARE



**Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj**

## ORGANIZIMI I BRIGADËS U BË NË LUFTË

Në luftë me pushtuesit gjermanë, më 9 tetor 1943, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në fshatin Arbanë, të Pezës heroike u formua Brigada III Sulmuese (Br. III S). Në brigadë u inkuadruan formua njësitë partizane të rrethit të Tiranës, si dhe shumë të rinj të qytetit të Tiranës që ju përgjigjën thirrjes së UNÇSH. Shumica e luftëtarëve të brigadës ishin luftëtarë të vjetër, me eksperiencë dhe të kalitur në beteja të ashpra kundër pushtuesit. Brigada i nisi luftimet me dy batalione të Grupit Partizan të Pezës, nga batalioni Krujë-Ishëm, batalioni "Dajti", si dhe çeta "Mateoti" dhe partizanë të njësiteve guerile të ardhur nga qyteti i Tiranës. Në shtabin e Br. III S u caktuan Hulusi Spahiu, komandant; Shahin Ruka, komisar; Hamit Keçi, zëvendëskomandant; Vasil Nathanaili, zëvendëskomisar dhe Thoma Kalefi intendent. Nazistët gjermanë e diktuan grumbullimin e forcave partizane për formimin e brigadës dhe një ditë më pas, sulmuan me forca të shumta në drejtim të Arbanës, ku ishin përqendruar njësitë e kësaj brigade duke e vënë në pozitë të vështirë, si dhe Grupin e Pezës. Partizanët ju përgjigjën me kundërsulm të shpejtë. Luftimet që u zhvilluan ishin të ashpra dhe përleshja arriti deri në trup me trup. Armiku pësoi humbje dhe u detyrua të tërhiqej. Ky ishte dhe pagëzimi i parë luftarak i brigadës. Për Luftën e Arbanës, komandanti gjerman, Herman Fran, do të shkruante në shënimet e tij, se "...dielli kishte vendosur të mos perëndonte kurrë atë ditë", ndërsa më poshtë do të vazhdonte "në këtë aksion të parë të vërtetë të gjermanëve në Ballkan dukej sikur gjithçka ishte përbetuar kundër nesh".

## ARTILERIA E BRIGADËS GODITI ASAMBLËNË TRADHTARE

Pas suksesit në Luftën e Arbanës, brigada u përqendrua në rajonin e Ballhaxhias dhe të Dorëzimit. Nga këto pozicione të përshtatshme filloi lëvizjen për të zbatuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm për të goditur asamblenë tradhtarë. Kështu më 18 tetor 1943, kur anëtarët e Asamblesë Tradhtarë, krerë të përfaqësuesve të organizatave që bashkëpunonin me pushtuesin u mblodhën për të legalizuar pushtimin hitlerian të vendit tonë, artilleria e brigadës, e vendosur në kodrat e Saukut, qëlloi godinën e pallatit ku ishte mbledhur asamblëja. Goditja ishte përgjigja që po i jepte populli shqiptar aktit të turpshëm të tradhtarëve në kurriz të popullit shqiptar. Pas këtij aksioni, luftëtarët e Br. III S përbaluan me trimëri

• *Në radhët e Br. III-të S luftuan me heroizëm mbi 50 luftëtarë (gra dhe vajza) të cilat në moshë të re u rezistuan privacioneve të luftës. Shumë prej tyre drejtuan rininë dhe ishin në shtabet e batalioneve e të kompanive, ku midis tyre ishin dhe Heroinat e Popullit Emine Bahja dhe Ylbere Bilibashi, si dhe Heronjtë e Popullit, Myslim Keta, Rahman Parllaku dhe Rexhep Kolli*



në ditët në vijim sulmet e vijueshme të organizuara nga armiku në të gjithë zonat që rrethonin kryeqytetin, Tiranë. Brigada që me formimin e saj, ju desh të luftonte në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe në terren ku armiku kishte kushte të favorshme për të sulmuar nga shumë drejtime. Ndër luftimet më të ashpra të saj janë luftimet që u zhvilluan gjatë operacionit armik në Pezë e Çermenikë. Në fillim të nëntorit 1943, trupa të shumtë fashistë gjermanë sulmuan Pezën nga shumë drejtime, me qëllim për të asgjësuar këtë njësi luftarake. Brigada së bashku me forca territoriale të Pezës, hynë në luftime të ashpra me armikun nga të gjitha drejtimet. Por, pas katër ditë me luftime, duke sulmuar, mundi të çajë rrethimin dhe doli nga zona e Pezës. Me daljen e saj nga zona e nxehtë e Pezës, ajo përsëri u gjend në luftime në zonën e Çermenikë dhe të qarkut të Elbasanit. Së bashku me forcat partizane të Br. II S, goditën në befasi forcat nazistë gjermane brenda në qytetin e Elbasanit. Kështu në vijimësi brigada ka mbajtur disa herë me radhë nën goditjet e saj rrugën automobilistike Elbasan-Tiranë, duke e bërë të pakalueshme për armikun. Nazistët gjermanë, duke e ndjerë veten të kërcënuar, grumbulluan forca të shumta dhe, të ndihmuar nga tradhtarët e forcave bashkëpunuese sulmuan Çermenikën, ku ndodheshin dhe forcat kryesore të Br. III, II S dhe një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Luftëtarët e Br. III, II S, megjithëse në kushte të vështira, të terrenit dhe të ftohtit, të urinë, të veshjes së paktë dhe të keqe, luftuan trimërisht kundër një armiku shumë herë më të madh në njerëz dhe të pajisur me të gjitha mjetet luftarake të kohës. Rrethimi i bërë nga forcat naziste u çua me vështirësi të mëdha dhe njësite e repartet e tyre kaluan në zona të tjera në Jug të Shqipërisë.

## BRIGADA ME LUFTIME MBËRRITI DERI NË JUNIK

Operacioni i Qershorit 1944 e gjeti Br. III S me luftime në zonën e Skraparit. Me luftë të vazhdueshme kundër forcave armike, gjatë operacionit, ajo kishte fituar përvojë luftarake dhe doli me humbje të pakta. Luftëtarët kishin fituar përvojë dhe ishin të kalitur, për të bërë beteja edhe më të vështira. Me kalimin e Div. I S në Veri të vendit, Br. III S më 19 korrik 1944 kaloi Shkumbinin dhe u përqendrua në zonën Tiranë-Elbasan, aty ku kish luftuar në ditët

e para të formimit të saj, por që terreni dhe fshatrat dhe njerëzit ishin të njohur për të. Pas goditjeve të njëpasnjëshme gjatë muajve, korrik, gusht e shtator, brigada spastroi nga armiqtë zonën për rreth Elbasanit e Tiranës dhe, në bashkëveprim me forcat e Div. I S, goditi armikun pranë Tiranës, duke e detyruar të mbyllet në qytet. Më 20 shtator 1944, duke zbatuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm, marshoi nëpër zonat Tiranë-Martanesh-Peshkopi-Lumë-Malësi e Gjakovës dhe duke i kombinuar veprimet me forcat e Br. V S, luftoi kundër forcave të Muharrem Bajraktarit, si dhe forcave hitleriane në Kukës. Me luftime të ashpra, një pjesë e forcave të Br. III S më 8 tetor kaloi Drinin e Bardhë, hyri në krahinën e Krumës e të Hasit dhe më 16 tetor 1944 çliroi Tropojën, kurse shumica dërmuese e brigadës kishte kaluar kufirin për të ndjekur armikun në Kosovë. Në këtë kohë Br. III S bashkë me Br. V S u inkuadruan në Div. V S. Pas luftërash të ashpra partizanë e Br. III S çliroan Junikun. Në këtë mënyrë u çel rruga për çlirimin e qyteteve të tjera të rëndësishme të Kosovës nga brigadat partizane të Shqipërisë që ishin dërguar me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm për çlirimin e popullit Kosovar, nga pushtuesit nazistë gjermanë, si dhe nga tradhtarët e vendit. Partizanët e Br. III S si dhe të Br. V S me luftime të ashpra, në kondita të vështira, duke qenë gjithmonë përballë forcave superiore armike çliroan pas luftimesh të ashpra qytetet Gjakovë, Prizren dhe Pejë, ndërsa Prishtinën e çliroan më 20 nëntor 1944. Në këtë mënyrë të dy brigadat shqiptare shpejtuan çlirimin e popullit vëlla kosovar nga pushtuesit e tradhtarët. Populli kosovar është dëshmitar i luftës, i trimërisë e heroizmit të partizanëve shqiptarë, por ai është dëshmitar edhe i vështirësive dhe sakrificave që bënë luftëtarët e dy brigadave. Populli kosovar i priti vëllezërit shqiptarë me gëzim dhe u dha përkrahje si dhe ndau kafshatën e bukës me vëllezërit e tyre çlirimtarë.

## BRIGADA FURNIZOI ME KUADRO NJËSITË PARTIZANE DHE MORI LAVDI

E inkuadruar në Divizionin e V-të S, brigada vazhdoi luftimet kundër gjermanëve në thellësi të tokës jugosllave. Të njohura janë luftimet e brigadës kundër gemanëve, të cilët bënë përpjekje për të kaluar lumin Bistricë në drejtim të Malit të Zi. Kudo Br. III S luftoi me trimëri dhe justifikoi besimin që i dha Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, duke u kthyer në Atdhe e mbuluar me lavdi. Br. III S u kthye në një fidanishte kuadrosh. Nga radhët e saj dolën kuadro që e drejtuan atë në vazhdimësi. Nga kjo brigadë shumë kuadro shkuan drejtuan njësi të fuqishme luftarake si Div. V S e Div. VI S, si dhe në Br. XVIII, XXIII, XXIV, XXV S, etj. Në radhët e Br. III S luftuan me heroizëm mbi 50 luftëtarë (gra dhe vajza) të cilat në moshë të re u rezistuan privacioneve të luftës. Shumë prej tyre drejtuan rininë dhe ishin në shtabet e batalioneve e të kompanive, ku midis tyre ishin dhe Heroinat e Popullit Emine Bahja dhe Ylbere Bilibashi, si dhe Heronjtë e Popullit, Myslim Keta, Rahman Parllaku dhe Rexhep Kolli. Brigada i dha atdheut jetën e 256 luftëtarëve të cilët janë yje të pashuar të lirisë dhe kujtohen e nderohen në breza.

## AKTUALITET

*Hapa konkretë për realizim me sukses të objektivave të parashikuara në planin afatshkurtër dhe afatmesëm*

## SHBA-Shqipëri, konsultime dypalëshe në fushën e mbrojtjes

• *Ministri Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen e pakushtëzuar të SHBA ndaj Shqipërisë. Sipas ministrit Peleshi, bashkëpunimi i shkëlqyer që karakterizon marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve është përkthyer në një kontribut të vyer në përpjekjet e vendit tonë për të qenë eksportues të sigurisë, jo vetëm në rajon, por si një partner i besueshëm i SHBA-ve dhe NATO*

Përfaqësues të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Departamentit Amerikan të Mbrojtjes zhvilluan në Tiranë, konsultimet dypalëshe në kuadër të bashkëpunimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, duke hedhur kështu bazat e një bashkëpunimi intensiv afatmesëm dhe afatgjatë.

Në takimin mes dy delegacioneve u diskutua mbi situatën aktuale në rajon dhe më gjerë, si dhe u trajtuan me hollësi një sërë projektesh në fushën e modernizimit dhe logjistikës.

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi konfirmoi gjatë fjalës së tij përkushtimin e vendit tonë në ruajtjen e stabilitetit, paqes dhe sigurisë jo vetëm në rajon, por dhe më gjerë. Ai garantoj se Shqipëria do të jetë gjithmonë garant i vlerave demokratike dhe perëndimore, si parime bazë të diplomacisë së Tiranës.

Ministri Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen e pakushtëzuar të SHBA ndaj Shqipërisë. Sipas ministrit Peleshi, bashkëpunimi i shkëlqyer që karakterizon marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve është përkthyer në një kontribut të vyer në përpjekjet e vendit tonë për të qenë eksportues të sigurisë, jo vetëm në rajon, por si një partner i besueshëm i SHBA-ve dhe NATO.

Delegacioni amerikan kryesohej nga z. Spencer Boyer, zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Mbrojtjes për Politikën Evropiane dhe NATO. Takimi u asistua nga ekspertë të fushës së të dy palëve. Delegacionet ranë dakord se integrimi në strukturat euroatlantike i të gjithë Ballkanit Perëndimor si dhe prezenca ndërkombëtare në rajon, konsiderohen të domosdoshme dhe faktor stabiliteti.

Ky takim zgjeroi linjat e bashkëpunimit me qëllim transformimin e kapaciteteve institucionale të



sigurisë dhe ato ushtarake, duke mbështetur dhe zbatuar se bashku projekte konkrete si: mbështetja e FARSH për rritjen e kapaciteteve të Grup - Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, Mbrojtjen Kibernetike, Edukimin Profesional Ushtarak, Trajnimin dhe Ushtrimet dhe Modernizimin e Forcave Ajrore.

Në përfundim kryetarët e delegacioneve nënshkruan dokumentin bazë, në të cilin përshkruhen hapat konkretë për realizim me sukses të objektivave të parashikuara në planin afatshkurtër dhe afatmesëm. Shtetet e Bashkuara u angazhuan të ofrojnë një mbështetje edhe më të gjerë për përmirësimin e kapaciteteve në përballje me sfidat reale për Forca të Armatosura sa më efikase, në përmbushje të misionit dhe detyrave të tyre.

Zhvillimi i bisedimeve të këtij formati përkon me

30 - vjetorin e nënshkrimit të marrëveshjes së parë kuadër për bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara.

### NGJARJE TË RËNDËSISHME HISTORIKE PËR MUAJIN TETOR

- 4 tetor 1944 - U formua në Bicaj të Lumës Brigada e XXIV-të S. e UNÇISH
- 4 tetor 1937 - Ka rënë në Spanjë Heroi i Popullit Asim Vokshi, komandanti i batalionit të III i Brigadës Internacionale "Garibaldi"
- 7 tetor 1942 - Ra heroikisht duke lufuar në rrethim me fashistët, komandanti i njësiteve guerile të Tiranës, Heroi i Popullit Vojo Kushi, bashkë me shokët e tij Xhorxhi Martini dhe Sadik Stavaleci, në shtëpinë e qytetares Ije Farka.
- 9 tetor 1943 - U formua në Pezë Brigada e III-të S. e UNÇISH
- 10 tetor 1943 - U formua Batalioni i Pezës.
- 10 tetor 1943 - U formua Batalioni "Antonio Gramshi" i përbërë prej 170 vullnetarësh proletarë italianë. Nga ky batalion ranë dëshmorë 15 partizanë, kurse 24 të tjerë u plagosën.
- 10 tetor 1944 - U formua Divizioni i III-të S. i U.N.ÇI. SH., i përbërë nga Brigada 12-të, 14-të dhe e 19-të S.
- 11 tetor 1925 - Lindi në Tiranë Heroi i Popullit Myslim Keta.
- 11 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Sarandës prej Brigadës 12-të e 14-të S.
- 13 tetor 1944 - Brigada III dhe V Sulmuese të U.N.ÇI.SH. kaluan kuP rin për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit fashistë.
- 15 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Vlorës prej partizanëve të Brigadës 12-të Sumuese
- 16 tetor 1944 - U formua në Lozhan të Korçës Brigada e IX-të Sulmuese e U.N.ÇI.SH., prej batalioneve "Fuat Babani", "Reshit Çollaku", "Skënder Çaçi", "Tomorri" dhe "Hakmarrja".
- 17 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Kuçovës prej Brigadës VIII dhe XVI Sulmuese.
- 18 tetor 1943 - U qëllua me top pallati ku ishte mbledhur Asambleja Kuislinge, që do të legalizonte pushtimin e ri të Shqipërisë nga nazistët gjermanë, e cila shënon edhe ditën e armës së Artilerisë së Ushtrisë Shqiptare.
- 20 tetor 1942 - U formua çeta e Kolonjës.
- 20 tetor 1944 - U bë mbledhja e II-të e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar
- 24 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Korçës.
- 28 tetor 1940 - Italia fashiste sulmoi Greqinë.
- 28 tetor 1941 - Demonstratë e madhe antifashiste në Tiranë.

*I ngarkuari me punë i Ambasadës së SHBA, takim me Ministrin e Mbrojtjes*

### Shqipëria, vend partner dhe aleat tepër i besueshëm për Aleancën



• *Nga të dyja palët u shpreh shqetësimi për konfliktin në Ukrainë dhe rëndësia e mbështetjes nga aleatët. Në të njëjtën kohë u diskutua për situatën në veriun e Kosovës, si dhe ndikimi i mundshëm në stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor*

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, priti në një takim zyrtar, të ngarkuarin me punë të Ambasadës së SHBA në Tiranë, z. David Wisner.

Ministri vlerësoi rolin dhe përgjegjësitë e misionit të SHBA në vendin tonë, duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakushtëzuar të SHBA për zhvillimin e kapaciteteve të FARSH dhe bashkëpunimin e shkëlqyer në fushën e Mbrojtjes.

Gjatë takimit u diskutua mbi mjedisin aktual të sigurisë,

sfidat në kufirin lindor të Aleancës, situatën rajonale dhe luftën në Ukrainë. Fokus të veçantë gjatë këtij takimi mori siguria kibernetike, angazhimet e vendit tonë në kuadër të NATO dhe bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes me SHBA.

Ministri i Mbrojtjes foli gjithashtu me z. Wisner për rolin dhe angazhimet e vendit tonë për garantimin e paqes dhe sigurisë në rajon, duke u shprehur besimplotë në thellimin e bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes.

Nga të dyja palët u shpreh shqetësimi për konfliktin në Ukrainë dhe rëndësia e mbështetjes

nga aleatët. Në të njëjtën kohë u diskutua për situatën në veriun e Kosovës, si dhe ndikimi i mundshëm në stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Z. Wisner shprehu mirënjohjen e tij për rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe kontributin e vendit tonë për Aleancën duke vlerësuar Shqipërinë si një vend partner dhe aleat tepër i besueshëm, ku mbështetja e SHBA do të jetë e vazhdueshme për përmirësimin e kapaciteteve të FARSH në përballje me sfidat e kohës.

## ANALIZA

# Gjashtë betejat e humbura dhe fundi turpërues i luftës së Rosisë - Putiniste

Gjeneral © Piro Ahmetaj\*

Në kapacitetin e ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s, kam vijuar të ndjek me interes të shtuar mbi 550 ditë luftime të përgjakshme në fushbetet e/ për Ukrainës/n. Në të njëjtën kohë kam ndarë/publikuar disa 10-ra vlerësime strategjike jo vetëm në median brënda/jashtë vendit por edhe me koleg/personalitet të sigurisë në konferenca dhe panele diskutimi të Këshillit të Atlantikut dhe Institutit të Luftës në Washington; Bruksel, Qendrën Marshall, Gjermani, Londër, Paris, Sofie, Prishtinë, Kolegjin e NATO-s Romë, etj.

Nga ana tjetër, pa pretenduar kurrësi të "privatizoj të vërtetën shteruese" kam refuzuar me vetëdije të bëhem pjesë e "tallavasë egocentrike", pasi, kurrësi nuk kam kohë të shpërdoroj me shterpësinë e mendimit të "kuvendarëve të emëruar"; dallisjet e analistëve të gjithëditur dhe rambo-sekserëve të vetë-(de)graduar Gjeneral, që turfullojnë nëpër banaqe mediatike për skenarë, avion, tanke, trashe, "bunkerë, atomik, rezerva strategjike dhe ditët e qametit", duke e shpjeguar kështu, "luftën jo vetëm për Ukrainën" me konceptet e Luftës së Dytë Botërore; të luftës së ftohtë, fushatave të Carit, në mos të kohës se gurit!

Po ashtu, pas 18 muajsh do duhet risjell në vetëdijen publike, se udhëheqës të deformuar nga paranojat e (mbi) pushtetit dhe nostalgjik të "lavdisë së ushtrisë së kuqe" në Kremlin dhe jo vetëm; politikanë të korruptuar dhe kamikazë anti-perëndimorë si dhe sekserë të interesave të oligarkisë (përfshi në Shqipëri), e mbivlerësuan fuqinë ushtarake të Rosisë me peshoren tradicionale [numur tankesh; Mig/29 (pothuaj ekuivalent me F-35); numër mbushjesh/armë bërthamore, strategë mëndje-ndryshkur, etj]. Për pasojë parashikuan skenarin më ogurzi: "në mos punë javësh, maksimumi 3 muaj Rusia do ta celebronte me lule, këngë dhe valle fitoren e lavdishme të pushtimit të Ukrainës si dhe triumfin ndaj NATO/BE.

Por falë gjakut, rezistencës heroike të Ukrainës martire si dhe mbështetjes së pakushtëzuar të Aleancës Euro-Atlantike, asgjë nga këto nuk ndodhi.

Për ta thënë edhe më qartë, në vijim po paraqes: "6 betejat e humbura si dhe fundin turpërues të Luftës që e pret Rusinë-Putiniste":

Beteja e humbur nr.1: ka dështuar për të pushtuar për 3 muaj Ukrainën (as me tanke dhe raketa as me lule dhe valle), as deri në 9 Maj 2022, as mbas 18 muajsh, as nuk e ka për ta zhvilluar kurrë paradën e fitores madhështore në Kiev. Pra nuk ka mbetur më asnjë pikëpyetje, madje as në Kremlin që e ka humbur këtë betejë/objektiv strategjik.

Në të kundërt, mbas më shumë se 18 muaj jo vetëm që nuk ka arritur këtë objektiv, por është futur i rraskapitur në llogoret e Zaporizhia, Oblast, Klishchiivka, Bakhmut, etj duke lënë



në fushëbetet: "rreth 30% të territoreve të pushtuara dhe të shpallura me referendume si pjesë të Mëmës-Rusi; 250 mijë të vrarë; më shumë se 5 Trilion € kosto e luftës, ose mbi 3 here më shumë se Prodhimi i Përgjithshëm Neto i Rosisë (1.8 trilion € për 2022); duke rënur kështu rëndë moralin e ushtrisë!"

Nga ana tjetër, duhet theksuar edhe më qartë se pavarësisht fushatave të dëshpëruara si shtet terrorist ndaj popullsisë civile, Spitaleve, Hidrocentraleve, tubacionit ndërkombëtar të amoniakut; avantazheve nga mbrojtja në bunkere/transhe për të penguar kundërofenzivën e Ukrainës, Rusia ka dështuar jo vetëm për të arritur këtë objektiv strategjike (pushtimin) por bashkë me të ka humbur edhe inisjativën strategjike dhe epërsinë operacionale në fushëbetet.

Beteja e humbur nr.2: Rusia e ka humbur betejën për të sfiduar fuqinë ushtarake të NATO-s, si dhe për të kërcënuar kufijtë, interesat dhe vlerat Euro-Atlantike.

Në të kundërt, lufta jo vetëm e forcoi solidaritetin/mbështetjen për Ukrainën dhe kohezionin mes vendeve të NATO-s, por edhe i zgjeroi kufijtë e Aleancës.

Më konkretisht, NATO u zgjerua me Finlandën dhe së shpejti me Suedinë, pra arriti në 32 ose 2 fishin e vendeve që trashëgoi nga lufta e ftohtë (16 vende deri 1990), ndërsa statusi Ukrainës në Samitin e fundit në Lisbonë, u ri-konfirmua/rrit në nivelin e "Komitetit NATO - Ukrainë" ose e thënë ndryshe me afër së kurrë pranë anëtarësismit.

Mbas 550 ditë luftimesh të përgjakshme është vërtetuar, (ndoshta me 2-3 përjashtime nga aktorë kontravers pa intuitë strategjike), se Rusia-Putiniste e ka humbur po ashtu betejën dhe shpresat për të minuar kohezionin mes NATO-s dhe BE, duke përdorur "gazin si armë gjeopolitike" apo duke kërcënuar (si shtet terrorist) me fuqinë bërthamore!

Në planin e mbështetjes ushtarake, deri aktualisht në terren kanë mbritur mbi 95 % e paketës së armatimeve të gjeneratës së fundit nga SHBA, UK, Gjermania dhe nga pothuaj të gjitha vendet e NATO-s (tanke Abrams, Challenger, Leopard, sistemeve Patriot, Dronë Bajraktar, Avion dhe helikopter luftimi, municione artilerie, etj), si garanci për të mbështetur kundërmësymjen e fitores së merituar të Ukrainasve,

por dhe të mbështetur dhe e bekuar nga Perëndimi

Beteja e humbur nr. 3: është vetë-diskredituar dhe ka humbur betejën për të tronditur rendin dhe mekanizmat e sigurisë globale.

Që në krye të herës, por edhe në mbi 18 muaj luftime, vërtetuan se agresioni ushtarak i Rosisë Putiniste, nuk ishte vetëm kundër sovranitetit të Ukrainës por edhe: "kërcënim serioz ndaj rendit global të sigurisë, kufijve të demokracisë, si dhe ndaj interesave dhe vlerave Trans-atlantike (USA/UN/UK/NATO/BE)".

Në të kundërt, Rusia-Putiniste gjendet sot më e izoluar dhe më e diskredituar se asnjherë më parë në historinë e saj. Nga 195 (përfshi Kosovën) vetëm 4 shtete (Koreja e Kim-Jongut dhe 3 shtete terroriste të Afrikës) e njohën këtë aventure neo-naziste. Po për shkak të kësaj lufte rrezikon potencialisht përjashtimin nga 5-shja vendimarrëse e Këshillit të Sigurimit/OKB si dhe është lëshuar nga Gjykata Ndërkombëtare është lëshuar "urdhër arresti për krime lufte" ndaj Putinit dhe më tej për listën e Gjeneralëve dhe oborrtarëve zullumqare rreth tij.

Beteja e humbur nr.4: jo vetëm është "zhgënjyer" por ka mbetur e turpëruar për të tërhequr Pekinin zyrtar në një aventur gjeostrategjike si dhe përfshirë Kinën në hapjen e një fronti të ri lufte ndaj Taivanit, dhe ndoshta jo vetëm.

Në të kundërt, që në fillim të kësaj ndërmarrje kriminale (Shkurt 2022), edhe pse Kina ishte kundër sanksioneve ndaj Rosisë, me qetësinë tipike Aziatike mori refuzimin diplomatik të Pekinit (Ambasadori Kinës në OKB e quajti Luftë këtë rast).

Po ashtu, është fakt që në 18 muaj, Kina nuk i ka dhënë asnjë premtim dhe as mbështetje me programe dhe armatime ushtarake Rosisë, si dhe së fundmi e paralajmëroi fort Moskën Zyrtare për mos-vendosjen e armëve bërthamore në Bjellorusi, etj.

Kështu, dështuan me turp llogaritë/zvarritja djallëzore e pinjollit të KGB-së (Putinit), dhe bashkë me të, "obortarët e diplomacisë dhe gjeneralët e lemerisur" nga Putini, të cilët nga "deliri fitores së padiskutuueshme" as nuk e kishin konsideruan që "Kina nuk bën lojën e askujt kur vjen fjala për interesa gjeostrategjike dhe gjeopolitike, por edhe nuk mund të

jetë kurrësi aleate e natyrshme me Rusinë në luftën kundër USA dhe BE".

Beteja e humbur nr.5: megjithë perden e hekurt staliniste, Putinistët e kanë humbur edhe betejën për të mbajtur kohezionin dhe krenarinë perandorake të kombit Rus.

Në të kundërt, 250 mijë të vrarë në fushbetet; me shume se 5 Trilion € kosto 550 ditë/natë lufte, ose mbi 3 here më shumë se Prodhimi i Përgjithshëm Neto i Rosisë (2022 = 1.8 trilion €); ka leqendisur jo vetëm moralin e ushtrisë, epërsinë operacionale, iniciativën strategjike por edhe rolin dhe peshën gjeopolitike të kombit Rus.

Ndoshta për "merit të armës bolshevike të disinformimit" është krijuar një mjegullnajë rreth shpërdorimit (si limon i shtrydhur) të mercenarit/terrorist të salçiqeve (Progozhin),4 si ndër përpjekjet djallëzore të Putinit për të rikuperuar kohezionin e kombit si dhe moralin e rrënuar të ushtrisë. Nga ana tjetër, Moska pretom se do të rekrutojë edhe 420 mijë rezervistë për në vijën e trasheve/frontit deri në fundin e vitit, ose në palcën e dimrit 2023.

Beteja e humbur nr.6: e përsëris se fatmirësisht Rusia - Putiniste jo vetëm ka humbur edhe betejën për të ndezur një front të ri lufte duke frymëzuar grupet kriminale, axhendën e politikanëve të korruptuar si dhe ekstremistët e tipit Dodik në Ballkan, apo për të ricikluar oshilacionet e Beogradit zyrtar duke kërcënuar "deri me agresion ushtarak nën inspektimin e Ambasadorit Rus në Serbi ...", jo vetëm kundër sovranitetit teritorial të Kosovës, por edhe kundër prezencës së NATO/KFOR-it me mision atje ... ?

Në përmbyllje e përsëris edhe më fortë se dështimi në 6 betejat e sipërpërmendura janë vetëm fillimi i rrokullimës drejt humbjes turpëruese të luftës që e pret Rusinë - Putiniste.

Konsideruar në këto, jam i bindur se, bashkë me humbjen turpëruese të Luftës për pushtimin e tërësisë territoriale të një vendi sovran/Ukrainës, Rusia do të diskreditohet për rolin dhe peshën gjeopolitike në Botë, përfshi Ballkanin perëndimor,

Në shtesë, në cilësinë e ekspertit të sigurisë kombëtare, do t'i këshilloja faktorët me peshë politike si dhe aktorët shtetërorë të Tiranës Zyrtare që: "humbja turpëruese e luftës, kolapsi ekonomik dhe diskreditimi ndërkombëtar, përfshi në Ballkan që e pret Rusinë-Putiniste, mbetet një rrethanë e favorshme gjeopolitike në dobi të faktorizimit të RSh në tavolinat e vendimarrjeve të mëdha (SHBA/NATO/UN) si dhe për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat mbarëKombëtare në Rajon, Mesdhe, etj!"

\* Ekspert për SK, Rajonin dhe NATO, Zv/President i Këshillit të Atlantikut; Anëtar i Bordit "Israël House", si dhe Ish:Këshilltar i Presidentit & Zv/ShShPFA, Përfaqësues Kombëtar Ushtarak në NATO.

## OPINION

TEMENARAT NDAJ TË HUAJVE JANË TË RREZIKSHME PËR FATET E KOMBIT

# Të mos e pengojmë e dekurajojmë Albinin për hir të të mëdhenjve

SHPENDI TOPOLLAJ

• *“Sikur të më dhuronit gjithë botën, megjithëse jam shumë i varfër, nuk do të vihesha në shërbim të askujt, kundër interesave të vendit tim”.*

Jeronim De Rada - “Testamenti politik” i vitit 1902



duhet pranuar se këto 33 vjet nuk kemi dëgjuar nga ata të tribunës, në takime, konferenca e mitingje, thirrje naive si “Rroftë miqësia e pathyeshme shqiptaro - amerikane”, siç bën dikur me jugosllavët, sovjetikët, kinezët e drejtin me të birin. Se këto përgjërime nuk i hanë as ata vetë, pasi ende u kumbojnë veshët nga thirrjet ulëritëse “Poshtë imperializmi amerikan” apo “SHBA - janë njëkohësisht edhe tigër prej letre edhe xhandari ndërkombëtar i popujve”. Por pika më e ndjeshme e qëndrimit të gabuar që aktualisht po mbahet nga ana e politikanëve të huaj është ai ndaj Kosovës, pra ndaj Kombit tonë.

A nuk e tregoi këtë ajo shtëpia e verdhë në Mat që mori famën e shtëpisë misterioze të Balzakut, dhe a nuk mjaftoi dërgimi në Hagë i drejtuesve të UÇK për t'i hequr aureolën e lavdisë kësaj lufte? Ndërsa sot, diplomacia ndërkombëtare i është turrur me të gjitha bateritë Albin Kurtit, duke i bërë presione absurde, duke e kërcënuar dhe për turpin e saj, duke vendosur sanksione ndaj Kosovës, se sipas tyre po tregohet kokëfortë në bisedimet me Vuçiqin dhe nuk po pranon asociacionin. Dhe me këtë kor janë bashkuar deri diku edhe zëra në Kosovë si dhe politika zyrtare e Shqipërisë. Vërtetë nuk i njohin serbët këta, të paktën pas vitit 1918? Vërtetë e kanë humbur kujtesën deri atje sa të harrojnë krimet e tyre? Vërtetë nuk i nuhasin dredhjet e Vuçiqit që as firmos dhe as e mban fjalën për çdo marrëveshje? Po si është e mundur të ulesh e të bisedosh me atë që e thotë troç se as të njoh dhe as do të të njoh ndonjëherë? Edhe diplomacia perëndimore, vërtetë pandeh se një marrëveshje e bërë me shantazh, pra e detyruar, do të shkojë gjatë?

Ato marrin jetë dhe bëhen të besueshme vetëm kur palët shprehin vullnetin e tyre të lirë, pa ja imponuar askush. Kjo diplomaci, haptazi e njëanëshme, pse nuk vë kusht respektimitin e të drejtave nga të dyja palët,

respektivisht në komunat serbe në Kosovë, por edhe për ato shqiptare në Luginën e Preshevës? Asociacioni, duhet kuptuar drejtë: ai është veprim me larghedhje i cili nuk i mbyll mospajtimet mes dy vendeve, por vetëm se u hap rrugën atyre. U jep nacionalistëve serbë mundësinë që të mos e lënë asnjëherë të qetë Kosovën dhe qeverinë e saj me ato grupet e armatosura të banditëve, dhe synon nga ana tjetër të krijojë idenë se kosovarët nuk ndërtojnë dot shtet. Kjo, në analizë të fundit, krijon vështirësi serioze që në të ardhmen të realizohet bashkimi kombëtar, pra i Kosovës me Shqipërinë.

Dhe pikërisht ky i fundit, për mendimin tim, është qëllimi kryesor i të ashtuquajturit asociacion, për të cilin janë vënë në lëvizje me gjithë energjitë dhe djallëzitë e tyre qarqet ultranacionaliste, klerikale dhe ushtarake në Serbi. Dhe ta dini mirë; ata shfrytëzojnë jo vetëm zbutjen e toneve të perëndimorëve, por edhe mbajtjen e isos nga qeveria jonë. A nuk flet fare qartë për këtë edhe agresioni propagandistik dhe ndërhyrja brutale e grekëve në Himarë? Si është e mundur të lejohet kjo? Janë pasoja këto që vinë nga disa shkaqe, ku më kryesori është ai që edhe qeveria jonë i kërkon Albin Kurtit t'u bëjë lëshime poshtëruese dhe me pasoja të dhimbshme serbëve, duke shkelur mbi gjakun e Heroit Adem Jashari dhe mijra e mijra djemve e vajzave të tjera. Por askush se thotë se cilat të drejta po u shkelen serbëve në Kosovë. Ata, vendosën vetë të bojkotojnë zgjedhjet vendore, se kërkojnë shkak për sherr. Mirë, ja do të përsëriten ato, se ndofta kjo është më e udhës në situatën e krijuar; po sikur ata sërish të mos marrin pjesë, si i bëhet kësaj pune. Për nga agresiviteti, padrejtësia dhe krimet e kryera, askund nuk ndryshon Serbia nga Rusia, por më thoni: a keni dëgjuar ndonjëherë perëndimin që t'i kërkojë presidentit Vododymyr Zelensky që t'i bëjë lëshime V.V.Putinit apo

të ulet në tavolinë me të për bisedime. Po bëhen dy vjet që në Ukrainë po vrihen çdo ditë njerëz të pafajshëm, por perëndimi dërgon armë e municione. Pra pse dy standarde? Përgjigja është e nënkuptueshme; pra Kosova duhet të lëshojë nga integriteti, sovraniteti, territori e autoriteti i saj për interesat e tyre. E po jo, nuk mban erë të mirë kjo, ndaj edhe qëndrimi i Kryeministrit Albin Kurti duhet përsëritur nga ne dhe duhet inkurajuar.

E kemi lënë vetëm pikërisht kur ai, qeveria që drejton dhe sidomos Kosova ka nevojë për ndihmën tonë diplomatike. Ata sytë të ne i kanë. Mendoni sikur të tilla kërkesa e presione të na bënin perëndimorët ne shqiptarëve për ta lëshuar Himarën dhe Kryeministri i Kosovës të ishte në një mendje me ta apo të ngrinte zërin më shumë se ata. Çfarë do të mendonim ne? A nuk do ta quanim atë tradhtar të interesave kombëtare? E pra, edhe ata në Kosovë, kanë plotësisht të drejtë t'i konsiderojnë politikanët tanë burracakë, të tillë. E përmendim shpesh mençurinë dhe veprën e të parëve tanë, por si i zbatojmë porositë e tyre?

Fjala vjen, a e mbajmë parasysh atë mësimin e çmuar të Jeronim De Radës (që në “Testamentin politik” të vitit 1902 kritikonte politikat imperialiste ndaj Shqipërisë) se “sikur të më dhuronit gjithë botën, megjithëse jam shumë i varfër, nuk do të vihesha në shërbim të askujt, kundër interesave të vendit tim”. Ja pse e përmenda qysh në krye Epikurin e 23 shekujve më parë, i cili me filozofinë e tij rreth ataraksias, pra paqja dhe liria nga frika, edhe pse e pranonte ekzistencën e Perëndive, përsëri nuk predikonte nënshtrimin ndaj tyre. Edhe ne, nëqoftëse nuk e ndihmojmë dot Albin Kurtin dhe qeverinë e tij në këto momente historike, kur luhet me të ardhmen e Kosovës, të paktën të mos e pengojmë e dekurajojmë për hir të të mëdhenjve.

Sado epikurian të jesh, nuk mund të rrihsh indiferent ndaj politikës, pasi të paktën këtu te ne, ajo nuk të ndahet këmba - këmbës. Pastaj, kur bëhet fjalë për të sotmen dhe të ardhmen e Atdheut, askush nuk duhet mbyllë sytë e të bëjë sikur nuk sheh apo të qepë gojën dhe të mos e thotë fjalën e tij. Ca më shumë, kur veç problemeve që vet politikanët tanë krijojnë mes tyre me qëndrime shpesh aspak korrekte, madje dhe të dënueshme, në lojë kanë hyrë edhe të huajt, që duke shkelur çdo normë elementare në marrëdhëniet mes shteteve, po e bëjnë baltë, duke luajtur me fatet tona, sikur Shqipëria të ishte mall pa zot. Patjetër që në emër të interesave dy e shumëpalëshe, do të ketë koordinime në politikat e jashtme nga ana jonë, do të ketë marrëveshje dhe traktate me detyrime të përbashkëta, që garantojnë bashkëpunimin, do të ketë shkëmbime e ndihma patjetër, deri dhe veprime ushtarake sipas rastit që kjo botë e trazuar imponon etj. etj. por kjo nuk do të thotë që të kalohet në nënshtrim apo në atë që po lakohet pak si shpesh se ne e kemi dorëzuar sovranitetin. Kush është ai që e paska atributin e sovranitetit dhe vepron me të si t'i dojë qejfi, përveç popullit shqiptar?

Ai që do, mund t'i dhurojë ndokujt shtëpinë e tij, por jo Atdheun. Qoftë dhe në emër të mirënjohjes e miqësisë, qoftë se ai është i fuqishëm dhe i pasur, qoftë se diku duhet të mbështetemi. E ca më keq akoma, kur miqësia apo më drejtë besimi që kemi, nga ai i fuqishmi shfrytëzohet për t'i përçarë më tej forcat politike e si rrjedhojë vetë popullin. A nuk e ktheu vitet e fundit, ambasada amerikane, politikën tonë në një shportë karavidhesh.

A nuk e lidhi artificialisht DASH atë shpikjen inatçore “Non grata” me shpartallimin e opozitës shqiptare që zor se do ta marrë veten edhe për dekada të tëra? Po këta dudumët tanë pse nuk e thonë hapur se nga erdhi kjo e keqe, por i vinë si frikacakë anash e anash si hajdutët e vreshtit? Është fakt i padyshimtë se te ne gjithkush i bashkohet pa asnjë rezervë cilësimit aleat strategjik të SHBA. Por kjo nuk do të thotë që në luftën politike të përdoren termat banale se ne jemi pro amerikanë dhe ju jeni grupimi anti-amerikan. T'i servulosesh Amerikës, mendoj se është shumë më e keqe sesa ta qortosh apo të shfaqësh mospajtim me të, kur nuk e ka mirë apo kur preken interesat tona. Mendoni sesa e neveritshme dhe fëminore tingëllon teoria se Amerika do të vendosë situatën në Shqipëri, ajo do të realizojë një drejtësi të kulluar, ajo do u vërë hekurat politikanëve abuzues, por prisni se “Ajo e kap lepurin me qerre”. Po ç'punë ka një shtet i anës tjetër të planetit me drejtësinë e Shqipërisë edhe pse mund të ketë dhënë ndihmesën e saj për ndërtimin e organeve të reja, gjë për të cilën i jemi falenderues. Nuk besoj se e ka dhënë këtë ndihmë për të na vënë kapistallin dhe për të na trajtuar si koloni të vetën. Është e njëjta gjë sikur këtë ta pretendonte dikur edhe Kina e Mao Ce Dunit, se edhe ajo nuk i kurseu ndihmat për ne. Për hir të së vërtetës,

ESSE

# Letra e pa dërguar

Nga Neki Çako

## Dëshmori Cane Shaqo Bega

Kalojnë vite, kalojnë edhe shekuj e kujtimi për dëshmorët mbetet i freskët në mendjet tona, në kujtesën tonë historike. Brezat që vijnë do t'i mbajnë në zemër dëshmorët, për t'i bërë ata flamuj që të valiviten rrugëve e sheveve tona të lirisë. Liria ndërtohet me jetëra, ndërtohet me gjak, ndërtohet me dëshmorë. Kurse, dëshmorët janë nderi dhe krenaria e popullit tonë martir. E atij populli që synon ta fitojë lirinë shekuj me radhë dhe që kërkon, e din ta ndërtojë lirinë. Dëshmorët janë ndërgjegjja më sublimë dhe vetëdija, e ngritur lart, deri në pedestalin e vetëflijimit. Ata jetuan për ne. I kemi në krye gjithkund e gjithherë. Me një diell në gj, me një rreze në ballë. Lundrojnë mbi detin e gjakut të flijuar për liri. Në paqe e në luftë, në fushë e në mal. Ata janë atje, këtu...! Një varr, një gurë, një lapidar, një përmendore. Lapidarë të lirisë ishin vetë ata, që u bënë flakadanë të përjetësuar. Diell me rreze të liria, me dritë pranë lirie. Liria bashkohet me Atdheun. Gëzim e hare në çdo anë. Dritësim diellor, rrezegjak!

Dëshmorët janë vetë krenaria jonë kombëtare! Ata janë këtu bashkë me ne. Ata janë vetë liria jonë!

E' h sa e gjatë na duket rruga për të ardhur tek ju! Le të ndalemi pak tek akti sublim i dëshmorit Cane Bega. Rruga nga Nivica në drejtim të Luadhit e pastaj në atë rrëpirë, shteg të ngushtë dhishë, drejtë pyllit, në ato bokërima stërralli, për në zarrel drejtë fshatit Vërmik. Ecim gjunjë këputur deri tek shtëpia e Rakip Bletës aty, ku ju dha ndihma e parë dëshmorit Cane Bega. Ndërhyrja ishte e menjëhershme por, që fatkeqësisht nuk mundi të mbi jetonte. Prita në pabesi, të ha! A' h plumb i pa besë! Edhe pse plumbi i parë kapi në zemerek të pishqollës që mbante Canja me vete, dhe për momentin ja devijoi drejtimin, dhe mundi ta shpojë vetëm në ijë, ai me shkathtësinë e tij mundi ta nxjerë atë nga kllëfi, por pa mundur të shtjerë pasi një plumb i dytë e kishte mbërthyer në nofull për ta rrëzuar atë lis në tokë, se ju e dini që lisi nuk këputet me një të rënë. Misioni ishte i madh Vlore-Gji-



rokastër. Letra duhej çuar! Nuk di ç'farë u bë me letrën por ajo su gjënd kurrë! Canja e kishte dhënë fjalën, o e dorzoj në destinacion o jap jetën! Fatkeqësisht mbriti atë që nuk dëshironte! Grupi I ballistëve kur e pa të shtrirë në tokë u thye drejt Ramicës, aty do të binin në përpjekje me çetat e Hysni Kapos ku dhe do të gjenin fundin e tyre. Kuja do të përhapej shpejt. Gjëma ishte e madhe. Populli do ta përcillte në ligjërimë.

Në Bletaj përmbi Vërmik/Cane Bega ra në pritë! Cane Shaqo Bega lindi në Nivicë të Kurveleshit në një familje të thjeshtë u rrit me edukatë dhe frymë patriotike. Të parët e tij, baba Shaqo dhe gjyshi i tij Alem Bega kishin marrë pjesë me armë në dorë në luftimet kundër pushtuesve osmanllinj në vitet 1880 - 1908. Gjithashtu në vitin 1912 në shpalljen e panvarsisë deri në vitet 1914 kundër çetave andarte, voroepirote. Pak vite të klasave fillore i kreu në vendlindje në Nivicë. Ishin një familje e madhe dhe varfëria kishte pllakosur kudo, ndaj u detyrua të punonte aty në fshat për të siguruar bukën e gojës. Rropatej duke punuar ato pak toka dhe tu shërbente bagëtive si të vetmet burime ushqimi. Në vitin 1935 do të kryente shërbimin e detyruar ushtarak dhe këtë për një periudhe kohore prej dy vjetësh. Pas përfundimit të shërbimit ushtarak ai do të punonte në Tiranë në ndërmarjen e



ndërtimit së bashku me disa bashkëfshatarë të tij Niviciotë. Pushtimi më, 7 prill 1939 nga okupatorët fashistë italianë, Canen do ta gjente në Tiranë. Në keto ditë të rënda të pushtimit, Cania bashkë me dy shokët e tij bashkëfshatarë, Xhule Memishahu dhe Bejo Bresho mundën të siguronin nga një armë dhe u rreshtuan të gatshëm, për të luftuar kundër forcave fashiste italiane. Armët nuk ishin në gjëndje pune, ishin të sabotuara, të ndodhur në këto rrethana ata krah forcave për çlirim, mundën sëish tja rrembenin armët armikut! Në këto ditë brënda në Tiranë u perfshi aktivisht kundër agresionit fashist i cili tashmë kishte pushtuar vëndin tonë. Të dëshpëruar dhe të hidhëruar jashtë mase, që të tre u kthyen drejt vëndlindjes së tyre në Nivicë. Te mbushur me urrejtje ata u trgonin bashkëmoshatarëve të tyre se duhet të bashkoheshin në luftë për çlirim! Të siguronin armë dhe të bashkoheshin për një qëllim, çlirim-in e vëndit nga okupatori dhe zgjedha e shtypjes. Gjëndja e rëndë e luftës, përfshiu edhe fshatin Nivicë të Kurveleshit. Në vitet 1940-1941 do të shtrihet fronti i luftës Italo - Greke. Duke parë rrethanat e luftës Cania që nga viti 1942 shtëpinë e tij e ktheu në një bazë e strehë të sigurtë për lëvizjen e luftës nacional - çlirimtare nga ku shihej edhe mundësia për fitoren e lirisë. Në muajt e parë të vitit 1942 njësitë

dhe çetat e para partizane gjetën strehë dhe bazë të sigurtë në shtëpinë e Cane Bega, ku nuk ngeli pa u perfshirë as vëllai i tij Hysniu familja si dhe cdo familje tjetër Niviciote e më gjerë. Hysniu ishte një luftëtar i zoti dhe drejtus operacion-al, ishte i shkolluar. Ai ishte komisar kompanie në brigadën e gjashtë sulmuse. Cania nga ana e tij siguron-te armatime veshmbathje dhe ushqime të cilat mblidheshin në bazë, në shtëpinë e tij dhe pastaj shpërndaheshin në njësitet partizane në teritor, në zonën e parë operative Vlorë-Tepelenë- Gjirokastër. Në gusht të vitit 1943 ishte rreshtuar partizan në çetën e "Avni Rustemit." Mori pjesë në luftimet e Libohovës si edhe në rrethimin e Grehotit ku ndodheshin forcat italiane në shtator te vitit 1943. Mbas kapitullimit të italisë fashiste duke qënë se ishte vetë i dytë vëlla në luftë në batalionin "Asim Zeneli", Cania kërkon leje për tu kthyer pranë familjes për ti ardhur sadopak në ndihmë, pasi gjëndja ekonomioke ishte tepër e vështirë. Pas disa kohë qëndrimi në fshat, ai merr një detyrë të rëndësishme në rolin e korjerit dhe dërgohet në Vlorë. Ai shoqërohej edhe nga Aqif Kapo Bega. Misioni ishte Vlorë - Gjirokastër . Para ngarkimit të misionit, Cania do të angazhohej edhe në luftën e Drashovicës ku edhe ketu aftësitë e tij ishin për tu vlerësuar. Rruga ishte e gjatë dhe plot të papritura. Duhej vigjilencë. Cania kurrë nuk e kishte menduar se aty do t'i ndodhte edhe tragjedia e jetës së tij. Një plumb i pa besë ja ndërpreu ëndërrat në tetorin e vitit 1943. Shtëpia e tij ngeli bazë e rëndësishme e luftës, në Nivicë të Kurveleshit, Tepelenë. Cane Shaqo Bega me vendim nr. 74 dt. 1 gusht 1985 është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, një vendim i merituar, por i vonuar nga pengesa të stisura e dashakeqe. Për këtë aktivitet, trimëri e besnikëri ndaj luftës e atdheut është dekoruar me urdhëra dhe medalje të Presidiumit të Kuvëndit Popullor. Gjaku është e vetmja metaforë e kuqe, që vdekjes i jep kuptim, përjetësisë rrënjë! I përjetshëm kujtimi dhe vepra juaj Cane Shaqo Bega!



## TRADITA

## NË KËRKIM TË VESHJES SË BUKUR KABASHISHT

Xhemal MEÇI

Studiues &amp; " Mjeshtër i Madh"

Fshati i bukur i Kabashit të Pukës shtrihet në shpatin malor jugor të malit të Krrabit (Monti di Puka, Mali i Pukës). Po kështu quhej në Lashtësi Kabashi- Pukë. Duke qenë për shekuj qëndër e rëndësishme banimi, por njëkohësisht edhe stacioni i udhës Via Publika, (nga e ka marrë emrin, si e pohon më 1637 Fran Bardhi, dhe e verteton prof. Çabej, më 1977,) VIA PUBLIKA – Udhë Pukë, -PUKË. Edhe Kështjella mbi Shkallë Qytetz, kohën e Perandorit Bizantin, Justinianit, Quhej Kështjella Pukë. Kurse gjatë Mesjetës nga PUKË, mori Emrin SHPAL nga manastiri, Abscia e Shën Palit, nga më të psurat në Shqipëri deri nga viti 1608, duke pasë edhe një seminar, ku mësimi jepej SHQIP për priftërinjtë, gjakojt që përgatiteshin për Malet e Veriut. Prandaj Kabashi ka trashëguar veshje popullore me vlera, një ndër të cilat mban emrin "VESHJA KABASHISHT", sepse mori shtrirje edhe jashtë Kabashit krahas "Veshës PULTAKE" dhe "Veshës PUKORE" e lashtë, (me një xhubletë të thjesh-tuar),

Siç dihet historikisht, në këtë veshje u ruajtën elemente të përbashkët të dy besimeve. Ngjasimet vërehen në xhurdi, në brez, në paranikë, në pështjellakë, në kapole, si edhe në disa zbukurime të natyrës pagane. por ndryshimet kryesore u bënë tek pështjellaku, me pala, ngjyrosur në të kuqe, prandaj mori emrin kanac (kana, një lloj lëmyshku mbi gurë, që kur shkrihej merrte ngjyrë të kuqe). Prandaj ngjyrat. që janë më të gjalla e më të theksuara, ku shquhej e kuqja, aq sa në disa krahina, mori emrin "VESHJA KUQE".

Përhapja kësaj veshjeje në Tropojë e Kukës (Malzi e Has), shpjegohet nëpërmjet martesave. Nusët nga Puka shkonin me veshjen e re aq të bukur, me kanac aq sa me kalimin e kohës mori përhapje në Tropojë nga gratë e besimit mysliman, sa u krijua përshtypja se kjo veshje ishte me origjinë nga Tropoja. Si e tillë u pranua edhe në FFK të Gjirokastrës si edhe vet Instituti i Kulturës Popullore Tiiranë e pranoi si fakt, gjë që specialistët e veshjeve të Pukës e kundërshtonin, sepse kjo veshje ka dalë për herë të parë në Kabash (Pukë) dhe pastaj përmes martesave është përhapur. Në favor të këtij fakti flisnin mjaft njohës të mirë të veshjeve të zonave si: Ymer Kadria, Asllan Beqiri, Ukë Ismajli, Lluqa, Kapllan Ismail Laçi. Fran Pali, Vitor Shahini, Zeq Tafilaku, Riza Man Hoxha etj.

Mbi këtë bazë, studiuesi Mustafa Beqri, disa vjet N/drejtor i Pallatit të Kulturës Pukë, kreu hulumtime krahas veshjeve edhe për trashigiminë



etnokulturore të fushave të tjera të Pukës, aq sa në sajë të interesimit të tij Puka zuri vend nderi në Ekspozitën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, organizuar nga Ministria e Kulturës, si edhe Akademia e Shkencave, Instituti i Kulturës Popullore në Shkodër, 1976, nën kujdesin e Zv/ Kryeministrit, Manush Myftiu.

Në Tropojë, më e vjetër është veshja e NGUSHT, që përbëhej nga: fustani, këmisha e bardhë, e gjatë deri nën gju, pështjellaku, i përparmi më i gjatë dhe më i gjërë se i prapmi, jeleku, mëngoret, çorapët, opingat etj. Më vonë ka filluar të përdoret edhe veshja e Kabashit me disa ndryshime që i përshtateshin krahinës ku u përhap kjo veshje. Pra, në këtë rreth kemi dy veshje. Në mjaft fshatra të Tropojës, nusja duhej të sillte në pajën e saj dy veshje: të ngushtën dhe të gjanën (kabashisht), të nesërmen, ditën e divanit, duhej të dilte me veshjen tjetër të zonës.

Në rrethin e Kukësit, në Malzi (Shumri Kukës), ashtu edhe në Tropoje, vihet re se ngjyra e kanacit nuk është vetëm e kuqe, por edhe me ngjyra të tjera. Pra, kanaci përdoret i kuq, ngjyrë violete, jeshil etj. Kuptohet se këto ndryshime ngjyrash vijnë si rezultat i përpjekjeve për t'ja përshtatur kanacin e kuq veshjes së tyre të mëparshme.

Në rrethin e Tropojës, të moshuarat, është rrënjësuar me tepër dashuria për veshjen e ngushtë. Sa shprehnin keqardhjen që nusët e tyre nuk po e veshin më veshjen e ngushtë tradicionale, (siç e ka hulumtuar mësuesi Musa Elez Hoxha nga Puka, dhëndër në Krasniqe).

Veshja e re kabashisht ka evoluar vazhdimisht edhe në Pukë. Mund të themi se kjo veshje ka njohur dy faza kryesore: në fazën e parë, që duhet të ketë lindur aty nga shek XVII, kjo veshje ka pasur këto pjesë përbërëse: kanaci kabashisht, si pështjellak deri te gjujtë. Dhe ishte vetëm dy polsh me përmasat 60 x 57 cm. Në atë veshje dalja e kanacit rrotull përbën fazën e dytë, aty nga fillimi i shekullit XIX në fshatin Kryezi, (nisur nga që duheshin mbuluar tlinat e gjatë deri nën gju ku vinin çorapët e gjata të leshta me mjaft zbukurime formash e ngjyrash. Kështu që kanaci rrotull ka çorapët e modelit të vet, e jo njëngjyrshe. Në vend të paranikut u përdor një rizë, shami mëndafshi, e verdhë (e sarme), me thekë. Ngjyra e kuqe pëlqehet shumë, prandaj me të ngjyhej kanaci e duvaku i nusës.

Para tri vitesh u thashë disa vizitorëve austriakë se një grua me veshje të tillë a mund të jetë e ndrydhur dhe e keqtrajtuar!? PËRKUNDRAZI!. Punimi i KANACIT ishte i vështirë. Jo çdo grua mund ta përgatiste. Ato ishin me emër. (Nëna ime Zyla Sali Meçi

kishte 6 çika e tre djem, prandaj mësoi me durim sa arriti të përgatiste me sukses, mbi 10 kanaca). Për përgatitjen ndiqej kjo radhë pune: merrej lesh dellesh i butë, i cili lahej, shprishej me dorë e LNUREJ me gërhanë metalikë. Gjatë lnurjes, leshi ndahej në dy cilësi: në TYMEN (fije të gjata) dhe IND (fijet e shkurtra). Leshi tymen bëhej shtëllunga dhe tirej në furkë me bosht poshtë, që sillej rreth vetvetës, ndryshe nga tjerrja e perit të zakonshëm. Indi tirej më trashë dhe përdorej për të bërë lidhjet e fijeve të tymnit gjatë rrahjes në vegje. Leshi tymen endej jashtë në një hapësirë rreth 12 m gjatësi mbi dy hunj nga njëra anë dhe po aq në anën tjetër, duke e kaluar perin në mes të dy hunjve në formë diagonale. Kjo ende numërohet edhe me krena. Një krye ka 10 fije. Pastaj, në një vend të pjerrët vendosen dy shkopinjtë të tjerë në formë kërrabe, gjysmë metri larg nga njëri-tjetri. Sipër tyre vendoset shuli i vekëve (vegjëve), i cili rrotullohet si cikrik, duke i mbledhur penjtë me radhë. Pastaj fillon punimi në vegjë. Si mbarohet kanaci në vegjë, bëhej qepja e poleve, me qenë se me një pol dilte shumë i shkurtër. Për përgatitjen e palave, kanaci futej në ujë shumë të ngrohtë, sa mezi durohej dora. Pastaj shtrihej mbi një sofër të madhe dhe fillonte formimi i palëve, e cila formohej duke e mbledhur kanacin me të dy duart njëherësh e duke i ngjeshur. Krahas ngjeshjes, bëhej qepja me penj në të dy polet. Penjtë hiqeshin vetëm pasi të ishte tharë kanaci në diell pa e shtrydhur Ngjyrosja bëhej vetëm kur vinte koha për ta përdorur. Palat qëndrojnë derisa kanaci bëhet i papërdorshëm. Palët e kanacit, me hapjen e mbylljen e



tyre i jepnin një bukuri të veçantë veshjes dhe përdorueses së saj. Tani fundet me pala si të kanacit përdoren më tepër në fshat, sidomos në zonat e thella. Në të kaluaren, veshja e re kabashisht zbukurohet sipas shtresave dhe klasave shoqërore. Grate e të pasurve mbanin shami të mëndashta, të qëndisura me fije ari. Fije ari e argjendi vihej edhe mbi çdo palë. Në Festivalin Kombëtar të Gjirokastrës, 1978, në paradën e kostumeve, kostumi festivi i Kabashit mori çmim.

Sot del detyrë që kjo veshje e bukur popullore, ashtu si dhe veshjet e tjera, të ruhen, si pasuri kombëtare. Disa gra të talentuara (si Vjollca Ndue Gega Pukë, si edhe Trunë e tjerë i përgadisnin për shitje). Këto gra duhen përkrahur dhe stimuluar për ta vazhduar si çdo traditë tjetër të mirë të popullit tonë.



Kabashisht

Pukore

## DOSSIER

123 - VJETORI I LINDJES dhe 80-VJETORI I RËNIES HEROIKE TË KOMANDANTIT TË ÇETËS SË PARË ANTIFASHISTE

## Ahmet Cami – Biografi e shkruar me gjak si

Halil RAMA- Mjeshtër i Madh

Ahmet Cami  
1900 - 1943

Njëqintënjzetetë vjet më parë, me 8 gusht të vitit 1900, në fshatin Viçisht të Qarkorit të Dibrës, në një familje me tradita atdhetare e liridashëse lindi luftëtari dhe intelektual i shquar Ahmet Fetah Cami, i cili do të hynte në analet e Historisë së Shqipërisë si pjestar aktiv i dy luftimeve botërore dhe veçanërisht si themelues dhe komandant i Çetës të Gollobordës, ndër të parat çeta antifashiste të krijuara në Dibër dhe në gjithë Shqipërinë deri në fillim të vitit 1940.

Tre vit më parë, me Dekret Nr. 11726, datë 17.09.2020, Presidenti i Republikës Ilir Meta e vlerësoi dëshmorin e atdheut Ahmet Fetah Cami me "DEKORATA E ARTË E SHQIPONJËS", me motivacionin: "Për kontributin e shquar atdhetar në mbrojtjen e interesave kombëtare, pavarësinë e vendit dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar. Si komandant i Çetës së Gollobordës gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe luftëtar i paepur në shërbim të atdheut deri në flajmimin e jetës".

Ky vlerësim erdhi pasi kreu i shtetit konsideroi propozimin e bërë nga Kryesia e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ me kryetar gjeneral Rrahman Parllaku, Hero i Popullit dhe "Nderi i Kombit" dhe Bashkia Bulqizë.

Mbështetur në legjisllacionin në fuqi, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ (OBVL) me kryetar gjeneral Rrahman Parllaku dhe Këshilli Bashkiak i Bashkisë, Bulqizës, që në vitin 2017 i propozuan Presidentit të Republikës së Shqipërisë që t'i akordojë dëshmorit Ahmet Fetah Cami (pas vdekjes) dekoratën e lartë "NDERI I KOMBIT", për shembullin dhe trimërinë e tij në dy luftat botërore, me këtë motivacion: "Si pjesëmarrës i Dy Luftëve Botërore për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga forcat e huaja pushtuese, si komandant i Çetës atdhetare që në janar të vitit 1940 dhe i kthimit të saj në maj të vitit 1943 në çetë partizane, si dhe për pjesëmarrjen aktive në luftime, duke dhënë shembull trimërie e heroizmi."

## PINJOLL I FISIT ME HISTORI TË LAVDISHME NË LUFTRAT KUNDËR SERBËVE

Ahmet Fetah Cami ishte pinjoll i familje me tradita atdhetare e liridashëse. Që në moshë të rë, Ahmeti u njoh dhe u frymëzua nga ngjarje dhe episode të ndryshme trimërie dhe heroizmi të popullit shqiptar, si dhe të paraardhësve të tij, si të Mahmut Camit, i vrarë në luftën kundër forcave Osmane të komanduara nga Hajredin Pasha, të Shaban Mahmut Camit, i vrarë në luftimet për mbrojtjen e trojeve shqiptare kundër mësymjeve të forcave pushtuese serbo-bullgare, të Fetah Shaban Camit, që është quajtur si legjenda e Luftës së Parë Botërore në atë krahinë, i cili ka udhëhequr e

komanduar forcat e krahinës së Gollobordës kundër forcave pushtuese shoviniste fqinje serbo-bullgare, të cilin pasi e vranë e masakruan, e çvarrosën pas një jave dhe e kanë fotografuar e ia kanë çuar foton Pashiqit (Krajlit të Serbisë, ish-kryeministrit të Mbretërisë jugosllave) në Beograd, si dëshmi, se e kanë vrarë Fetah Camin.

Historiani Gazmend Shpuza në botimin e vitit 1986 "Kryengritja fshatare e Shqipërisë së mesme 1914-1915" (Botim i Akademisë të Shkencave të RPS të Shqipërisë - Instituti i Historisë), citon: "Krerët esadistë kishin marrë prej Serbisë të holla për rekrutimin e 2000 vetëve, porse nuk patën sukses në këtë drejtim, sepse nuk gjetën përkrahjen e banorëve të krahinave ku filluan të vepronin. Shanset e tyre u pakësuan, sepse pranë tyre qenë atashuar ushtarakë serbë. Forcat e pakta mercenare që mundën të mbledhin, edhe pse të përforcuara me ushtarë serbë, u thyen nga forcat shqiptare të komanduara nga Fet Cami, antiesadist i vendosur. Përpjekja u bë në përroin e Tërbaçit. Bandat u detyruan të tërhiqen brënda kufirit shtetëror të Serbisë. Sidoqoftë këto banda përbënin një shqetësim të vazhdueshëm për autoritetet kryengritëse." (f.375-376).

Në kapitullin "Lufta kundër forcave Serbe" të botimit të cituar më lart përshkruhet: "Forcat agresive serbe ndeshën në qëndresën e shqiptarëve sapo kaluan kufirin. Dan Cami me forca të pakta organizoi pritën e parë në Sepetovë. Forcat e shumta serbe nuk e patën të vështirë ta kapërcenin atë. Për shkak të kësaj qëndrese dhe të luftës së Fet Camit kundër bandave serbo-esadiste...shtëpitë e Camëve në Viçisht u bënë preja e parë e terrorit serb." (f.392).

Ahmeti i përjetoi ngjarjet e luftës për

• Duke folur në Berat më 21.10.1944, përfaqësuesi i Dibrës, Haki Stërmilli, ndër të tjera do të theksonte: "Dibra mburret dhe krenohet pse pat edhe shumë burra që e nderuan, pat djelm të shquar që iu kushtuan altarit të lirisë, ndër të cilët Ahmet Cami e shumë të tjerë që e puthën vdekjen me kangën e lirisë në gojë." (A.Q.Sh., F.40/AP,V.1944,D.23,fl.32).

pavarësi kombëtare dhe që pjesëmarrës me armë në dorë gjatë Luftës së Parë Botërore me çetat që udhëhoqën gjyshi i tij, Shaban Cami dhe kushëri Dan Cami e të tjerë pas vrasjes së Fetah Camit. Pasi vritet e masakrohet babai i Ahmetit, Fetah Cami, e merr dhe komandon çetën e Gollobordës Shaban Cami, gjyshi i Ahmetit, i cili i vendos për herë të parë pushkën në krah Ahmetit që në moshën 16 vjeçare dhe e merr në luftime kundër forcave pushtuese serbo-bullgare deri në Shkup, ku vritet në luftime edhe Shaban Cami, gjyshi i Ahmetit.

Të gjithë u flijuan si dëshmorë të atdheut. Ahmeti i përjetoi edhe ngjarjet e Kongresit të Lushnjës si dhe të Revolucionit Demokratik të Qershorit të vitit 1924. Ai ushqeu simpati për qeverinë e Sulejman Delvinës dhe të Fan Noli. (Shpallen dëshmorë të atdheut Fetah Shaban Cami dhe Shaban Mahmut Cami me Vendim të KE të rrethit të Dibrës nr. 72, me 23.6.1978- Fondi Nr. 489, Viti 1984, Dosja 192, fl. 26-43)

Mësimet e para i mori në shkollën 7-vjeçare të Zerqanit. Vazhdoi studimet e kreu arsimin e plotë ushtarak në Tiranë dhe studime në akademinë ushtarake. Punoi për disa vite si oficer gjatë kohës së Zogut në rrethet Shkodër e Gjirokastrë dhe për disa vite në Prefekturën e Elbasanit. Në qytetet ku punoi, Ahmeti është futur në rrethet intelektuale dhe ka marrë pjesë gjallërisht në diskutime e debate për probleme kombëtare si për organizimin e ushtrisë, të arsimit e të shkollës kombëtare, si dhe për disa reforma shoqërore, duke dhënë kontributin e tij, që të mos ishin gjysmake dhe formale.

Ka bërë protesta për ruajtjen e karakterit kombëtar dhe të pavarësisë të ushtrisë shqiptare. Si intelektual i ndiqte me shqetësim ngjarjet që zhvilloheshin në vend dhe në botë. Ai ka mbajtur e mbrojtur anën e krahut progresist dhe demokratik, të cilët mbi gjithçka vinin interesat kombëtare.

Ka denoncuar dhe kundërshtuar me nderinjetë penitrimin e të huajve në ushtrinë shqiptare, veçanërisht penitrimin e Italisë që para pushtimit. Prandaj ka shkruar deri tek Mbreti Zog në një takim me të dhe ia ka parashtruar gjendjen e ushtrisë.

## ORGANIZATOR DHE KOMANDANT I ÇETËS SË PARË ANTIFASHISTE TË DIBRËS

Ahmet Fetah Cami e ka pritur me nderinjetë të thellë pushtimin fashist italian. Prandaj që ditën e parë të pushtimit të Shqipërisë, tregon ish-kolegu i tij, Isuf Kokomiri: "...Më ka lënë një kujtim të pashlyer qëndrimi i Ahmetit, në fund të karrierës së tij ushtarake. Sapo që kthyer nga Kapshtica, pasi ikishte përcjellë për në Greqi, Mbretin tonë, Ahmet Zogun. U fut menjëherë në zyrë dhe përgatiti ca libra e materiale, të cilat i dorëzoi. Pastaj shkroi një deklaratë që përafërsisht më duket se kishte këtë përmbajtje: 'Unë jam betuar përpara flamurit që t'i shërbej shtetit shqiptar.

Tanimë që ky shtet nuk ekziston, unë nuk mund t'u shërbej të huajve'. Pastaj doli nga zyra dhe e la çelësin të varur tek sporteli. Doli jashtë dhe iu afrua flamurit. Ahmeti i ulur në gjunj puth flamurin kombëtar dhe jep dorëheqjen si oficer". (Libri "Ahmet Fetah Cami – Autobiografi e shkruar me gjak nga pjesëmarrësi i dy luftëve botërore", faqe 284).

Shembullin e tij e ndoqën edhe ushtarakë të tjerë të cilët vazhduan të jepnin dorëheqjen. Kthehet brenda natës në fshatin e tij të lindjes, në Viçisht të Dibrës. Ai e kishte mëse të qartë, se vetëm me luftë të armatosur, mund të çlirohej Shqipëria nga pushtimi fashist italian.

Këtë të vërtetë historike e pohon në kujtimet e tij edhe Uke Abdulla Cami (faqe 255 e këtij libri), i cili shkruan se që nga ardhja e Ahmetit nga Elbasani, në prill 1939 dhe derisa e caktuan për shoqërimin e Misionit Anglez, ka qenë shoqëruesi i tij në të gjitha aktivitetet dhe aksionet që ka zhvilluar Çeta e Gollobordës.

"Më 15 janar 1940 jemi mbledhur në Golovisht të dy grupet, njëri e kishte bazën në Tiranë dhe tjetri në Elbasan, të përbërë prej 18 vetave, Kemi ngritur çetën e parë në këtë zonë, për të luftuar kundër pushtimit fashist. Për ngritjen e çetës jemi mbështetur në Kuvendin e Nandë Maleve të Dibrës dhe jemi udhëhequr nga idea kombëtare e bashkëpunimit me të gjithë ata që sado pak kanë luftuar kundër okupatorëve si gjatë Luftës së parë Botërore, ashtu edhe gjatë Luftës së Dytë, me idenë e Vatrës dhe në zbatim të thirrjes së Antantës, për të luftuar për çlirimin e Atdheut...", shkruan Uke Abdulla Cami në kujtimet e tij të botuara në librin e mësipërm (Fq.255).

Më tej në vlerësim të rolit dhe kontributit historik të komandantit të kësaj Çete Ahmet Fetah Cami, Ukja shkruan se: "Më 7 Prill 1939, me ardhjen e okupatorit fashist në tokën shqiptare Ai (Ahmeti) dha dorëheqjen dhe u bashkua me Antantën kundër Boshtit, me idenë e plotë të Komitetit të Nandë Maleve të Dibrës (N.M.D) për bashkimin në luftë kundër okupatorit pa dallim feje, krahine e ideje... dhe për çlirimin e Atdheut dhe të kombit shqiptar, deri sa dha jetën në krye të betejës në Peshkopi, më 20 tetor 1943 kundër okupatorit nazifashist". (Libri "Ahmet Fetah Cami – Autobiografi e shkruar me gjak nga pjesëmarrësi i dy luftëve botërore", faqe 256-257).

## PAK HISTORI

Fillimet e qëndresës dhe rezistencës mbarëpopullore ndaj pushtimit fashist italian, ashtu si në të gjithë trevat shqiptare edhe në Dibër e në disa fshatra të zonës së Grykës së Vogël e të Gollobordës, nisën që ditën e 7 prillit 1939 të organizuar dhe zhvilluar nga krerët e Maleve të Dibrës. Kur kthehet në Dibër, Ahmeti mëson se kishin internuar e

(Vijon në faqen 9)





## DOSSIER

Çeta e Gollobordës, më 7 tetor 2023, Sesion Shkencor nga OBVL në Muzeun Kombëtar

## pjesëmarrës i dy luftrave botërore

## PROGRAMI i Sesionit Shkencor të datës 7 Tetor 2023

I. Dokumentar mbi veprimtarinë e Çetës Antifashiste Partizane të Gollobordës me komandant Ahmet Feta Cami.

## II. Kumtesa

1. Ahmet Cami, pjesëmarrës i Luftës Botërore (Z, Halil Rama - Mjeshtër i Madh)
2. Krijimi i Çetës Antifashiste të Gollobordës në Janar të vitit 1940 dhe kthimi në Çetë Partizane nga komandanti, Ahmet Cami në Maj të vitit 1943, (Dr. Z Kadri Dauti)
3. Dukuri Luftarake për Çetën Partizane të Gollobordës (Prof.dr. Bernard Zotaj)
4. Lufta për mbrojtjen e qytetit të Peshkopisë në vitin 1943. (Dr. Asllan Zemani)
5. Lufta e Çetave Partizane të Batalionit të Dibrës dhe e Çetës Partizane të Gollobordës për çlirimin e viseve shqiptare përtej kufirit dhe të qytetit të Dibrës së Madhe në vitet 1943-1944 kundër forcave pushtuese nazifashiste. (Prof. dr. Nebi Dervishi)

Drejtuesi i Sesionit Shkencor, historian i shquar Prf. Dr. Paskal Milo

• Tre vit më parë, me Dekret Nr. 11726, datë 17.09.2020, Presidenti i Republikës Ilir Meta e vlerësoi dëshmorin e atdheut Ahmet Feta Cami me "DEKORATA E ARTË E SHQIPONJËS", me motivacionin: "Për kontributin e shquar atdhetar në mbrojtjen e interesave kombëtare, pavarësinë e vendit dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar. Si komandant i Çetës së Gollobordës gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe luftëtar i paepur në shërbim të atdheut deri në flijimin e jetës".

mor në Shqipëri. Krahina atë natë ishte e rrezikuar nga forcat pushtuese të dy vendeve nga forcat pushtuese italiane dhe ato serbe.

## TË BURGOSURIT DHE DËSHMORËT E FISIT CAMI

Pas një aktiviteti të hapur dhe ilegal, Ahmeti arrestohet më 27 prill të vitit 1941 dhe dërgohet në Ostren, në Homesh dhe në burgun e Tiranës e të Burrelit së bashku me xhaxhallarët e kushërinjtë e tij për më se një vit e gjysëm. Akuzohej si organizatori kryesor i lëvizjes dhe të rezistencës në krahinë. Para Ahmetit ishin arrestuar 18 burra e djem të Camëve si dhe disa fshatarë nga Golloborda e fshatrat e Shupenzës.

Në burg Ahmeti njihet dhe zë miqësi me shumë të burgosur nga krahina të ndryshme të vendit, të dënuar apo të padënuar. Ai përmend në ditarin e burgut luftëtarë si Thanas Xhufka, Vasil Gjika dhe Naumi..., studentë në Normalen e Elbasanit. Në ditarin e tij ai shkruan: "Meqë komunistët qenkan aq patriot për çeshtjen kombëtare, atëhere edhe unë qenkam më bolshevik". Njeh Petro Markon, pjesëmarrësin e luftës të Spanjës. Njeh disa kosovarë e pezakë, të burgosur për të njëjtat motive. Pas vrasjes së vëllait të tij dhe pushkatimit të Ejupit e Musait dhe të Mexhit Lezit, e njoftojnë për vrasjen enigmatike e të pabesë të Sefer Ramiz Camit, i cili është dëshmor. (Më vonë bie dëshmor kushëri i parë i Ahmetit, Mahmut Dalip Cami në luftimet me Brigadën e 18 S).

Ahmeti me gjithë kushërinjtë dhe bashkëpunëtorët e tij dalin nga burgu në gusht 1942 me një vendim të rremë, të cilin e kishte paguar shtrenjtë, me 300 apo 600 napolona flori. Në shkresën e zv.Prefektit të Dibrës Mahmut Golemi të datës 22.6.1942 dhe të z/ministrit të MPM, Beqir Valteri shënohet lirimi. (AQSH, F.252, D.1637, V. 1942, Fl.188-189) - (Fotokopje)

Sapo u liruan nga burgu, u arratisen për 2-3 muaj nëpër malësi, sepse i kërkonin që t'i burgosnin përsëri. Ahmeti qëndroi në Grykë Nokë të Dibrës i strehuar tek Shaqir Rusi për tre muaj.

Me t'u kthyer në shtëpi, në nëntor 1942 e riorganizon përsëri çetën luftarake për zonën e Gollobordës dhe për disa fshatra të Grykës së Vogël. Kjo çetë bëri disa aksione për t'i mbrojtur këto zona, dhe punoi me fshatarët, që të mos binin nën ndikimin e propagandës fashiste e të bashkëpunëtorëve të tyre, si dhe organizoi punën për çeljen e disa shkollave në krahinë. Çeta e Gollobordës ishte më e madhe në numër dhe shumë më autoritare. Ajo çetë kishte simpati e besueshmëri në atë zonë dhe vepronte si njësi më vehte kundër pushtuesve italianë.

Në vjeshtë të vitit 1942, ku ra në kontakt me Zoi Themelin, komandanti

(Vijon në faqen 11)



(Vijon nga faqja 8)

çuar në Berat Uke Dan Camin, kreun e Malit të Gollobordës dhe Sinan Shaban Camin, kryeplakun e Malit të Gollobordës dhe kishin internuar edhe disa krerë të tjerë të Maleve. Menjëherë organizon rezistencën në krahinë dhe bën disa aksione në disa fshatra të Grykës së Vogël dhe të Gollobordës.

Në janar 1940 organizon dhe ngre çetën atdhetare antifashiste të Gollobordës, ku si komandant zgjidhet Ahmet Cami dhe si zv/komandant Uke Dan Cami.

Të 9 Malet e Dibrës kanë funksionuar edhe gjatë viteve të para të LANÇ deri në maj të vitit 1943, kur u asgjësuan si armiq disa nga krerët, që bashkëpunuan me pushtuesit nazifashistë. Në qershor 1943, kur filloi shpërbërja e organizimit të Maleve dhe e qeverisjes kolaboracioniste, filluan të zbatoheshin vendimet e Frontit Antifashist për organizimin e këshillave nacionalçlirimtare të pushtetit të ri popullor. Synimet e organizimit dhe veprimtarive të çetave atdhetare antifashiste, në fillim, kishin karakter kombëtar sipas traditës historike të Nëntë Maleve të Dibrës. Për krijimin e çetës së Gollobordës Ahmeti u mbështet tek traditat atdhetare e liridashëse të popullsisë së krahinës së Grykës së Vogël dhe të Gollobordës, tek urrejtja që ushqente popullsia e këtyre fshatrave ndaj pushtimit fashist. U arrit që popullsia e krahinës, të mos e njihje pushtetin kolaboracionist të pushtuesve fashist, të mos paguante taksat dhe të mos jepte të dhjetat e tokës

e të prodhimit.

Veprimtaritë në krahinën e Grykës së Vogël dhe të Gollobordës kundër pushtimit fashist derisa sa ndërroi jetë, i ka organizuar dhe udhëhequr luftëtaritë i luftës për liri e demokraci dhe për përparim shoqëror, Ahmet Feta Cami.

Gjatë viteve 1939-1941 veprimtaritë antifashiste janë zhvilluar në këto drejtime:

- Në mbledhjen e qindra vullnetarëve nga fshatrat e Shupenzës dhe të Gollobordës, për të shkuar dhe për të luftuar në Durrës kundër pushtimit fashist.

- Në organizimin e një pune politike kundër pushtimit fashist, me qëllim që popullsia në këto zona të mos binin pre e propagandës fashiste dhe kolaboracionistëve. Ahmeti është vënë në krye të punës politike, për sqarimin e popullit. Më 28 Nëntor 1940 ka folur para popullit në Homesh për këtë datë historike, duke u dhënë që të kuptojnë se vetëm të bashkuar në luftë mund t'i dilet zot vendit dhe të çlirohet Shqipëria.

- Në marrjen e një informacioni të saktë për zhvillimin e situatave politike në Shqipëri e në botë, për veprimtaritë antifashiste që zhvilloheshin në rrethet e tjera të vendit; të informoheshin për lëvizjet e armiqve, me qëllim që njerëzit të mos binin në kurthet e tyre. Mbi këtë bazë është organizuar shërbimi me roje në disa fshatra, tërheqja e shtypit nëpërmjet Kurt Camit, që bënte tregëti në Shupenzë e shkante në Tiranë e Dibër të Madhe për furnizim çdo javë, nga informacioni që merrnin nga njerëzit që bënë kontrabandë në Dibër të Madhe,

nga të njohur e shokë që vazhdonin të kishin pushtet, si dhe nëpërmjet rap-sodit popullor, Musa Izvira, që shkante sofër më sofër e konak më konak, siç e kujton populli i atyre fshatrave.

## DISA NGA AKSIONET QË KREU ÇETA E GOLLOBORDËS

Komandanti i çetës, Ahmet Cami organizoi punën për ndërmarrjen e kryerjen e aksioneve konkrete kundër pushtuesit fashist italian:

1. Në fund të muajit mars të vitit 1941 Ahmeti ka organizuar punëtorët e argatët, që punonin rrugën e zonës së Gollobordës, për pengimin e kolonës ushtarake italiane, që kalonte me municione nga Librazhdi në drejtim të Shupenzës dhe Dibrës së Madhe. Puntorët kanë marrë armët dhe përmbytur në lumin Dri një makinë me municione.

2. Më 2 Prill të vitit 1941 është organizuar aksioni për të sulmuar depot e armatimit të batalionit të divizionit "Firencie" të dislokuar në Vanastrane të fshatit Tërbaç, me një efektiv prej 600 ushtarësh italianë. Në këtë aksion u kanë marrë italianëve shumë armë dhe janë vrarë disa italianë si dhe një oficer i tyre. Ndërsa forcat e çetës nuk kanë pësuar asgjë, sepse aksioni që i mirëorganizuar me detaje. Me armët e rrëmbyera në dy aksionet, janë armatosur të gjithë luftëtarët e çetës e të krahinës. Për kryerjen e këtyre aksioneve forcat pushtuese italiane arrestojnë me 4 prill të vitit 1941 tetë vetë, 7 prej të cilëve ishin djem të Cameve dhe me 5 prill i fusim për pushkatim. Ejup Cami, meqë dinte italisht, u thostë: "Do t'na pushkatojnë. Meqë nuk jemi të lidhur, kur t'na vendosin në rrjesht, ne të shpërndahemi nga të gjitha drejtimet, për të shpëtuar!" Dhe kështu bënë. Por mbetën të vrarë Ejup Shahin Cami, Musa Rahman Cami dhe Mexhit Lezi nga Luznia. Ndërsa të tjerët largohen në drejtime të ndryshme dhe nuk i kapën dot. Arrestojnë 19 burra e djem të Cameve dhe disa nga Golloborda e Shupenza dhe i burgosin për një vit e gjashtë muaj në burgun e Tiranës dhe të Burrelit si antifashist me Ahmet Camin si kryetar i tyre. Gjat kohës së burgut ndërron jetë në burg Dilaver Cami nga torturat.

3. Në aksionin e 7 prillit 1941 gjatë përpjekjeve me pararojën e forcave pushtuese italiane apo të jugosllave, që ishin futur këtej Drinit, vritet Faslë Feta Cami, normalisti i Elbasanit, vëllai më i vogël dhe bashkëluftëtar i vendosur e besnik i Ahmet Camit. Faslë Cami njihet si dëshmor i parë i çetës atdhetare të Gollobordës dhe si mësuesi i parë dësh-

## 79-VJETORI

24 TETOR 1944, SULMI I FORCAVE TË BRIGADËS IX DHE XX PËR SHPORRJEN E NAZISTËVE GJERMANË NGA QYTETI JUGOR

# Historiku i Brigadës së IX Sulmuese

**B**rigada IX Sulmuese u formua në katundin Lozhan të Gorës, qarku i Korçës, më 16 tetor 1944. Komandant ishte Irakli Bozo dhe Komisar Mihallaq Ziçishti. Në përbërje të saj kjo brigadë kishte pesë batalione sulmues, të cilët kishin përvojë në artin e luftës. Në kohën kur u krijua brigada, shumë vende të Evropës Lindore po çliroheshin nga ushtria sovjetike, pra brigada IX i shtoi radhët e ushtrisë shqiptare, duke bërë të mundur çlirimin e vendit me forcat tërësisht vendase.

Kjo brigadë u krijua me qëllimin e shtimit të veprimeve ushtarake në zonën e Korçës. Detyra ishte të eliminonte autokolonat armike që lëviznin në aksin Janinë-Korçë-Manastir-Follorinë, Korçë-Pogradec-Tiranë, por detyra më e rëndësishme ishte çlirimi i qyteteve të Korçës, Ersekës dhe Bilishtit. Me marrjen e këtyre qyteteve armikut i pritëshin rrugët e komunikacionit dhe paralizohej tërheqja e ushtrisë gjermane nga Greqia për në Jugosllavi nëpërmjet territori shqiptar.

Urdhri për krijimin e brigadës u dha nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në përbërje të tij u caktuan batalione me përvojë në luftë kundër pushtuesve. Inaugurimi i brigadës u bë para efektivit të saj ku u rreshtuan të gjithë batalionet e saj.

Brigada kishte një armatim që dispononte e gjithë ushtria shqiptare në atë moment, ajo kishte armë të dhuruara nga populli, por edhe nga ndihmat aleate të hedhura me parashutë, si armë automatike, por që nuk plotësonin të gjithë numrin e pjesëtarëve të brigadës. Brigada ishte e pajisur me shërbim shëndetësor. Pranë shtabit të brigadës qëndronte një mjek dhe 2-3 infermiere vullnetare. Shtabi i brigadës ishte i përbërë nga Irakli Bozo, komandant; Mihallaq Ziçishti, komisar; Petro Papi; zv/komisar; Meleq Babani, përgjegjës rinie dhe Vangjel Marko intendent. Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX, që përbënte dhe një nga forcat kryesore pjesëmarrëse në operacion, kishte në përbërje të saj 1580 partizanë. E gjithë forca partizane në zonën e Korçës arrinte në 3000 veta, po të shtohen këtu edhe partizanët e Brigadës II me 1150, dhe brigada e XX-të me 430. Këtu mund të shtojmë edhe forcat guerile që vepronin brenda në qytete, si në Korçë dhe Bilisht, të cilat arrinin në rreth 1000 vetë.

Forcat armike që kontrollonin zonën e Korçës ishin më të pakta në numër, por të pajisura dhe mbështetura në tanke dhe artileri. Këto forca armike kishin nën kontroll vetëm rrugët kryesore dhe duhej të siguronin tërheqjen e forcave gjermane nga Greqia në Jugosllavi, e cila përbëhej nga Korparmata e 21. Në bazë të urdhrave të Shtabit të Operacionit, batalionet e brigadës morën të gjithë detyra të ndryshme në zona të ndryshme në bashkëpunim me batalionet e brigadave ndihmëse.

Batalioni I u caktua të asgjësonte garnizonin e Kolonjës dhe Leskovikut. Batalioni i II-të duhej të kontrollonte disa prej katundeve që kishin pranë rrugën automobilistike Qafë e Qarrit-Korçë. Batalioni III duhet të sulmonte garnizonin e Bilishtit dhe të kontrollonte kufirin në zonën e Kapshticës.



Batalioni IV në bashkëpunim me batalionin e I të brigadës së II duhej të sulmonte garnizonin e qytetit të Korçës dhe çlirimin përfundimtar të qytetit. Disa prej tyre edhe u diktuan në momentin kur dhe do të zinin pozicionet e luftimit, ata u goditën nga zjarri i artilerisë armike. Katër batalionet e brigadës u vendosën sipas urdhrave në pozicionet e caktuara. Të parët që u ndeshën me forcat armike ishin partizanët e batalionit I, të cilët mundën të futeshin thellë në linjat armike.

Nga Janina po tërhiqej një autokolonë e madhe me gjermanë, të cilët rrugës do të mblidhnin edhe disa nga garnizonet që kishin në Leskovik, Korçë dhe Bilisht. Kjo autokolonë u sulmua nga batalioni I i Brigadës IX në bashkëpunim me batalionin II të Brigadës II. Lufta ishte e ashpër, me sulme e kundërsulme, por falë errësirës, autokolona arriti të dalë nga rrethimi dhe të largohet në drejtim të Korçës. Ky largim i gjermanëve lejoi që forcat partizane të futën në qytetet e Leskovikut dhe Ersekës.

Në mesin e tetorit forcat partizane kishin nën kontroll të gjithë krahinën e Kolonjës, në dorë të tyre kishin rënë shumë materiale ushtarake të lëna nga armiku në ikje e sipër. Të katër batalionet raportonin suksese në zonat ku ishin caktuar. Ato filluan sulmin kundër forcave gjermane që gjendeshin të pozicionuara jashtë Korçës, duke pasur sukses dhe duke shkaktuar panik midis armikut. Kjo bëri që ato të tërhiqeshin në mënyrë të çrregullt drejt Korçës. Batalioni i katërt tentoi me sukses edhe bllokimin e rrugës Korçë-Pogradec, kjo i detyroi forcat naziste të mos kishin asnjë komunikim me forcat jashtë, duke shuar edhe shpresën për ndonjë ndihmë të mundshme.

Ky ishte një sukses në fushën e betejës për

dy brigadat që organizuan sulmin. Sukses ishte edhe për komandën e brigadës, e cila kishte vetëm pak kohë që ishte krijuar. Në bashkëpunim me Brigadën II, Brigada IX iu afrua lagjeve të jashtme të Korçës. Menjëherë mbi qytet filluan sulme të organizuar me qëllim shqetësimin e armikut. Duke e zgatur vijën e luftës, partizanët po ngushtonin rrethimin e armikut.

Të gjendur në dëshpërim gjermanët tentonin të tërhiqeshin prapa, andej nga kishin ardhur, nga kufiri grek. Forcat zbuluese partizane mundën të lokalizojnë saktësisht vendosjen e armikut dhe mënyrën se si mbroheshin. E gjithë kjo u arrit në bashkëpunim me forcat guerile që ndodheshin në qytet. U dha urdhër që rrethimi të ngushtohet edhe më shumë, forcat partizane intensifikuan sulmet, ato arritën deri në pazarin e qytetit, duke u ndeshur dhe trup me trup me gjermanët. Kjo i detyroi gjermanët që ta përqendronin çarjen e rrethimit në një pikë, verilindjen. U përdorën të gjitha armët e mundshme, që nga artileria dhe autobлиндat. Ata filluan të hidhnin në erë shumë pika strategjike të qytetit, por sidomos edhe depon e municioneve shpërthimi i së cilës shkaktoi një gjendje alarmi. Gjermanët kishin lënë vetëm një shteg për t'u tërhequr, shteg, i cili u bllokua menjëherë nga forcat partizane. Vetëm një pjesë e tyre mundi të shpëtojë dhe të largohet nga qyteti. Pjesa tjetër u vra ose u kap rob nga partizanët.

Ky ishte edhe sulmi i fundit i partizanëve, të cilët mundën ta çlironin përfundimisht qytetin e Korçës. Mbetej të bëhej edhe çminimi i zonave të pashpërthyer, operacion që u krye në bashkëpunim me njësitet guerile të qytetit.

I gjithë qëllimi i gjermanëve ishte të hidhej në erë qyteti i Korçës, që forcat naziste të kishin mundësi të largoheshin të pa shqetësuar.

Menjëherë forcat partizane dhe më saktësisht batalioni I i brigadës së IX dhe ai I i brigadës së II, u vunë në ndjekje të forcave armike. Forcat partizane iu drejtuan qytetit të Bilishtit, i cili mbahej akoma nga forca naziste. Qyteti u rrethua, por partizanët u gjendën përballë një sulmi të artilerisë armike. Pas shumë përpjekjesh partizanët i detyruan gjermanët të tërhiqeshin nga pozicionet e zjarrit dhe të strukeshin në kazemat e qytetit. I gjithë sulmi vazhdoi tërë natën e 25 tetorit duke i bërë gjermanët të tërhiqeshin drejt kufirit grek. Edhe pse dolën nga kufiri shqiptar gjermanët u ndoqën dhe u sulmuan duke u shpartalluar përfundimisht. Partizanët e Brigadës IX u futën dhe ndihmuan popullin grek nga forcat gjermane, në katundet Drenovon. Operacionet për çlirimin e Korçës u kryen në një kohë të shpejtë.

Kjo ishte rezultat i bashkëveprimit me batalionet e tjera të Brigadës II. Populli i Korçës iu rezervoi një pritje të madhe partizanëve kur këta u futën në qytet për nder të tyre u organizuan koncerte e festime. Populli i Korçës doli i gjithi nëpër rrugë dhe festoi me partizanët çlirimin e qytetit. Kori i qytetit për nder të kësaj ngjarjeje këndoi këngë patriotike, sidomos një këngë e cila ishte përgatitur posaçërisht për këtë ditë. Por shfaqje të tilla gëzimi kishte edhe në qytetet e tjera si Bilishti dhe gjithë qarkun e Korçës, të cilat zgjatën tërë natën deri në mëngjes. Menjëherë pas çlirimit të qarkut të Korçës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, dy nga batalionet e brigadës IX u vendosën në mbrojtje të qytetit të Korçës dhe dy të tjerë në mbrojtje të qytetit të Bilishtit. Detyrë ishte edhe mbrojtja e kufirit me Greqinë, e cila po mbante një qëndrim agresiv ndaj popullit shqiptar sidomos çamëve. Pas qetësimit të gjendjes forcat e Brigadës IX, që tashmë kishin hyrë në përbërje të Divizionit të IV, morën urdhër të largohen nga qarku i Korçës dhe të vendosen në Shqipërinë e Mesme në rajoni Krujë-Ishëm-Kavajë.



## 79 VJETORI

# BRIGADA E XXIV SULMUESE E UNÇSH LUFTOI PËR ÇLIRIMIN E SHKODRËS DHE NË MAL TË ZI

Në këtë 79 vjetor të krijimit të Brigadës 24/S veteranët, pasardhësit e tyre, të familjeve të dëshmorëve e invalidët e LANÇ dhe gjithë populli i Kukësit sjellin në kujtesë rrugën historike e luftarake të Brigadës 24/S, plot sakriþ ca, privacione dhe heroizma në gjithë inkursionin luftarak të saj kundër nazi-fashizmit dhe bashkëpunëtorëve të tyre dhe plot respekt e mirënjohje komandantit Ndreko Rino, komisarit Abedin Shehu dhe gjithë kuadrin drejtues që nga Abaz Arif Shehu, Muhedin Kërzhaliu, Rasim Guri, Hysni Dino, Hasan Myftari, Vehbi Shehu, Ismail Loka, Hasan Spahiu, Rrahman Palushi, Ahmet Onuzi, Nexhip Visha, Ymer Domi, Ahmet Ramallari, Hysni Shehu, Maliq Gashi, Sinan Hajdari, Haxhi Sinamati e Hazir Asllani.

Respekt e mirënjohje gjithë partizanëve të Brigadës që nga Abedin Shehu i pari në listën emërore e deri tek Destan Mici në fund të 1182 partizanëve, lavdi gjithë partizanëve që luftuan për një ideal të madh Lirinë duke e nënshkruar me gjakun e 43 dëshmorëve.

Gjatë muajit tetor 1944 Brigada e 24 S ndoqi këto probleme të veprimtarisë së saj në të gjithë fshatrat e Kukësit siç ishin: -Krijimi i Këshillave NÇ për të ndihmuar LANÇ, punë sqaruese për situatën dhe bindëse për plotësimin e batalioneve me partizan vullnetar e të mobilizuar, lidhja e popullit të Kukësit me Frontin N-Ç duke e shkëputur përfundimisht nga inþ uenca e Muharrem Bajraktarit.



Grushtet e Brigadës ndaj lëvizjeve të kolonave gjermane në rrugën Kukës- Prizeren mbi postat armike në afërsi të qytetit të vjetër të Kukësit, mbi mercenarët etj. Me urdhët të Shtabit të

Përgjithshëm të UNÇ më 31 tetor 1944 Brigada e 24/S së bashku me Brigadën e 18/S i prenë rrugën Prizeren-Kukës lëvizjes së kolonave gjermane.

Më 8 nëntor Brigada e 24/S pasi përshëndetet me banorët e Kukësit dhe të afërmit e tyre me urimin "U kthefshi me liri në ballë" u nisën për marshim të gjatë në rrugën luftarake - heroike drejt Tiranës, ku morën urdhërin luftarak për vendosjen gjatë rrugës Durrës-Tiranë me detyrë bllokimin e saj për të mos lejuar hyrjen ose daljen e forcave gjermane nga Tirana.

Të gjithë Batalionet e Brigadës bënë luftë vetëmohuese duke i shkaktuar armikut humbje të mëdha në njerëz dhe teknikë. Batalioni i parë sulmoi depon e karburantit. Lufta vazhdoi pandërprerje ditë e natë prej datës 11 deri 17 Nëntor 1944, kur u çlirua përfundimisht Tirana. Detyrën luftarake e kryen me sukses, por lanë në fushën e betejës 15 partizanë nga Kukësi: Abaz Peposhi, Dan Shahu, Elmas Ademi, Gani Duraku, Hakik Gjici, Idriz Gafurri, Maksut Rexhepi, Nuredin Braha, Osman Qenami, Ramadan Kotarja, Sabri Gjici, Sadik Palushi, Xheladin Mici Vehbi Shehu dhe Sherif Smana.

Pas çlirimit të Tiranës më 17 Nëntor 1944 u ngarkua me detyrë të ndiqte armiku në drejtim të Shkodrës, duke kaluar Milotin e Lezhën. Më datën 23 nëntor 1944 rreshtohet Brigada nën komandën e Ndreko Rinos, për të marrë detyrën luftarake dhe sqarimin e saj për asgjësimin e forcave gjermane duke kaluar edhe lumin e Matit dhe të Drinit për në Shkodër.

Më datën 24 nëntor brigada mbërrin në Bërdicë e Beltojë me zhvillime të përgjakshme luftimi ku bien dëshmorë: Emri Halilaj, Hasan Lika, Islam Xhahu, Isuf Seferi, Ymer Mata. Më datën 28 Nëntor morën Baçellëkun, kaluan Drinin dhe gjatë natës së 28-29 Nëntorit u bë luftë vendimtare, ku mëngjesin e datës 29 Nëntor Shkodra u çlirua. Kjo ishte fitorja më e madhe dhe e lavdishme e gjithë popullit shqiptar.

Më datën 1 Dhjetor 1944 Brigada u nis për në Mal të Zi, Ulqin e Tivar. Meqë nazistët gjermanë ishin larguar nga Tivari më 6 Dhjetor Brigada u kthye në Shkodër dhe mori detyrë për të vepruar në Malësinë e Madhe, Dukagjin e Kastrat dhe bjeshkët e Kelmendit për të ndjekë e shpartalluar bandat armike të komanduara nga krerët e reaksionit vendas si Idriz Jazo, Llesh Marashi e Prek Cali. Ndjekja e shpartallimi i këtyre bandave u bë në kushte të vështira dimri e terreni.

Nga luftimet e batalionit të Katërt të Brigadës ranë dëshmorë: Gani Onuzi, Hysen Koka, Halil Hasa, Ibrahim Lleshi, Mahmut Neçi, Musli Halilaj, Ramadan Kaculi dhe Rustem Shehu.

Në pranverën e vitit 1945 mbasi Brigada e 24/S kreu me sukses detyrat luftarake vazhdoi marshimin në drejtim të Tiranës ku më 15 Maj 1945 u shpëmda. Njëpër një turne luftarak plot aksione shoqëruar me 3 tore Brigada e 24/S u ballafaqua me dinjitet dhe epërsi morale për luftën e saj të drejtë antifashiste dhe çlirimtare. Lumjanët në lëvizjet popullore dhe luftërat kanë pasur prijëtarë e kapëdanë të mire, por si në UNÇ dhe në Brigadën e 24/S nuk kishte ndodhur asnjëherë.

## Ahmet Cami – Biografi e shkruar me gjak si pjesëmarrës i dy luftrave botërore

(Vijon nga faqja 9)

i Çetës së Gollobordës Ahmet Cami pranoi të bashkohej me Frontin Antifashist të LANÇ dhe në maj 1943, e shëndrroi çetën antifashiste të Gollobordës në çetë partizane të Gollobordës, ku pranoi edhe komisar, që u caktua mësuesi korçar i fshatit Radovesh, Spiro Velko, me të cilin njiheshin, sepse ishte kolegj me Fasliun dhe shkante shpesh tek shtëpia e Ahmetit.

Ahmet Cami që ftuar nga Spiro Moisiu, për të marrë pjesë me 10 korrik të vitit 1943 në krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Labinot, si komandant i çetës partizane më të njohur dhe që kishte bërë emër në Dibër në organizimin e rezistencës dhe të luftimeve që vitin e parë të pushtimit fashist italian dhe nga njohja që kishte me Ahmetin si kolegj që kishin punuar së bashku në Shkodër në vitet 1930. Por Ahmet Camin e kthejnë nga rruga, nga konjunkturën politike të kohës.

### ORGANIZATOR I KRIJIMIT TË BATALIONIT PARTIZAN TË DIBRËS

Ahmet Cami organizoi krijimin e Batalionit partizan me 23 korrik të vitit 1943 në fshatin Gjoricë e Epërme, si një fshat me një popullsi patriotë dhe më i sigurtë, sepse ishte Dalip Cami, xhaxhai i Ahmetit kryeplak, dhe dy miqt e tij Ramadan Mera e Shaqir Pali dhe Ferit Kaja, të angazhuar me lëvizjen antifashiste. Çeta e Gollobordës ka qenë pjesëmarrëse në krijimin e Batalionit të Dibrës, sepse Ahmeti e njihte artin ushtarak të kohës dhe e ndiente nevojën e organizimit të luftës në formacione më të mëdha luftarake. Ahmeti e zgjodhi fshatin Gjoricë e Epërme si vend më të sigurtë, për krijimin e Batalionit të Dibrës, për shkak të influencës që kish krijuar çeta e Gollobordës në këtë fshat, si dhe të lidhjeve të shumta familjare e fafeshnore, miqësore e shoqërore, që kishte ai. Çeta partizane e Gollobordës u bë një nga çetat më luftarake të lëvizjes nacional çlirimtare në Dibër dhe kreu një seri aksionesh. Në maj të vitit 1943 si çetë partizane menjëherë pas riorganizimit kreu aksionin e parë në Drenok kundër një autokolone që po shkonte për në Strugë.

Çeta e Gollobordës ka marrë pjesë në shumë luftime si në aksionet për çlirimin e Trebishtit, të Ostrenit, të Kërçovës, të Debërskës, të Kosovrastit dhe të Izvorit, të rrugës Dibër-Strugë, Spas e Sollokiç, Reshane, si dhe në luftimet për çlirimin e mbrojtjen e Zerqanit, në luftimet për çlirimin e Dibrës së Madhe dhe të Peshkopisë.

Ahmet ka qenë i pranishëm në dorëzimin e Shtabit të Divizionit italian "Firencia" dhe që ngarkuar të drejtonte forcat e Çetës së tij dhe të një pjese të Batalionit të Martaneshit për ruajtjen e rendit dhe

qetësisë në Dibër të Madhe, për t'i mbrojtur nga disa banda të panjohura, që ishin organizuar për të bërë vjedhje e shkatërrime të qytetit.

Gjatë udhëtimit për në Peshkopi Çetës së Ahmetit i bëjnë dy prita, një në Maqellarë. Por këtë pritë e kalon pa konflikt, sepse forcat kundërshtare ulin armët, kur informohen, se po kalojnë forcat e Ahmet Camit nga lidhjet e shumta miqësore e familjare. Prita e dytë iu bë në mbrëmje në Qenok. Aty Ahmeti përdori një taktikë të ndezjes së zjarreve në kodër të Qenokut, ndërsa forcat e Çetës kaluan në pjesën anësore të kodrës së Qenokut pa pësuar asnjë përpjekje e dëme. Në Peshkopi Çeta partizane e Gollobordës vendoset në Dobrovë. Në mesnatë i jepet urdhër të kalonë në Staravec. Në krah të Çetës së Gollobordës ishte vendosur Çeta serbo-malazeze prej 45 vetësh. Pse duhej të ishte ajo Çetë brenda kufijve të Shqipërisë????!!

Në këto luftime mbetën të vrarë partizani Lil Hasa, mitralieri partizan italian, Salvatore si dhe u plagos rëndë komandanti i saj trim, Ahmet Cami, i cili pas disa ditësh ndërroi jetë nga plagët e luftës më 30 Tetor në spialin e Tiranës, duke dhënë një shembull trimërie dhe heroizmi. Në luftën e Peshkopisë u plagosën edhe partizanë të tjerë të çetës si Esat Cami, Asllan Zeneli, Hidër Manjani dhe Bajram Toçi. Kjo çetë në luftimet për mbrojtjen e qytetit të Peshkopisë u dëmtua shumë.

Ahmet Cami dha për Luftën Antifashiste Nacional-çlirimtare, për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut gjithçka kishte. Ai shkriu të gjithë pasurinë e tij, duke dhënë edhe jetën. Akti i heroizmit të Ahmetit dhe të shokëve të tij, e frymëzuan çetën e Gollobordës, për ta vazhduar më me guxim e heroizëm luftën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazistë. Amaneti i tij i fundit për çetën ka qenë, për ta vazhduar luftën kundër pushtuesve të vendit, për të siguruar vëllazërimin e të gjithë shqiptarëve, për të evituar vëllavrasjen, që përpiqeshin të nxisnin elementë të ndryshëm kollaboracionistë me nazifashistët apo me jugosllavët. Populli i kësaj krahine e ngriti lartë emrin e Ahmet Camit, duke e vazhduar më me vull të luftën, duke e përjetësuar në disa këngë popullore, si dhe duke e quajtur çetën partizane e Gollobordës "Çeta Ahmet Cami".

Duke folur në Berat më 21.10.1944 përfaqësuesi i Dibrës, Haki Stërmilli, ndër të tjera do të theksonte: "Dibra mburret dhe krenohet pse pat edhe shumë burra që e nderuan, pat djelm të shquar që iu kushtuan altarit të lirisë, ndër të cilët Ahmet Cami e shumë të tjerë që e puthën vdekjen me kangën e lirisë në gojë." (A.Q.Sh.,F.40/AP,V.1944,D.23,f.32).

(Vijon në faqen 16)

## HISTORIA

Gjurmë lavdie nëpër faqet e “Historikut të fshatit Vajzë”, janë shkruar nga 1971 deri më 1980

# GJAK SHQIPTARI RRËZË BEUNIT NË FSHATIN VAJZË

Prof. Asoc. Zaho GOLEMI  
Irfan BIRBILAJ  
Trifon GOLEMI

Dokumenti i shkruar në gati dhjetë vite në Vajzë e ka fillësën tek orientimi i KP-së, të KE-së të Vlorës dhe ish-Këshilli Popullor më 30.5.1971, datë kur u krijua komisioni i përbërë: 1.Maliq Telo Sadushi, 2.Xhipe Mersin Kapaj, 3.Gani Mystehak Sulçaj, 4.Riza Çize Brahimaj, 5.Çize Hamit Elezaj, 6.Iliaz Zagoll Bilbilaj, 7.Piro Rexhep Hoxhaj, 8.Fejzi Sherif Sherifaj, 9.Kamo Tare Sheremetaj, 10.Hysen Sadik Brahimaj, 11.Rustem Rrapo Hametaj, 12.Reis Ali Xhezo, 13.Myfit Zaçe Nazaj, 14.Daver Hamit Elezaj, 15.Mynyr Resul Manaj, 16.Bino Zigur Kasaj, 17.Nexhip Xhelilaj. Maketi i historikut u shkrua dhe diskutua nga 1971 deri 1980. Historiku është daktilogruar në shkurt 1980, si dhe është konsideruar i përfunduar më 11.1.1981, në një mbledhje zgjeruar të Komisionit të bashku me bashkëfshatarët vajzotë në fshatin Vajzë. Mirënjohje dhe falënderim për ata që shkruan historinë e lavdisë së fshatit Vajzë!

Muzeumet dhe historikët që u krijuan pothuaj në çdo fshat të Shqipërisë ishin një bazë e dokumentimit të historisë sonë kryesisht të trashëguar gojore por edhe dokumentare aty ku ka qenë e mundur. Por kur historinë e lavdisë shqiptare e shkruajnë ata që i kanë jetuar ngjarjet dhe kanë qenë njëkohë me to sikurse ndodh me fshatin Vajzë që historikun e kanë shkruar ata që kanë qenë pjesëmarrës në Luftën e Vlorës, në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare por dhe në gjithë periudhën e ndërtimit të Shqipërisë, vlera dokumentare e treguar dhe e shkruar në historik rritet dhe besueshmëria merr vlera solide për brezat dhe për të vërtetën. Në fakt Historia është “përvoja e fituar përmes shembujve”. Ndoshta një pjesë e historishkrueve të Vajzës nuk i kanë lexuar autorët antikë si Herodoti, Tukudidi, Straton, Livi, Plini, Diodori i Sicilisë etj, por e kanë parë e vëzhguar e precur luftën dhe jetën në mënyrë aktive. Në fakt shkruarit e historisë së Vajzës kanë qenë vetë në betejë. Sikurse shkruan Çurçilli, “Betejat janë gurët kilometrik më të rëndësishëm të historisë”. Nga partizanët që zbritën nga mallet me lirinë një pjesë ndoqën shkollat ushtarake Brenda e jashtë vendit dhe u lartësuan në dije e kulturë, shfrytëzuan punime të Zyrës së Kartotekës e njohur ndryshe si dega e Historisë Ushtarake e ngritur që më 1950, por dhe botimet me vlerë “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake”, botimet “Kalendari ushtarak”, “Partizanët tregojnë”, e qindar vepra që u mundësuan nga krijimi i institucioneve të specializuara për botimet dhe studimet në fushën e historisë ushtarake, pasi edhe historiku i Vajzës në shumicën e tij është një histori luftrash e përpjekjesh për të ruajtur lirinë dhe mbijetesën përballë pushtimeve. Vend të veçantë zënë formacionet luftarake të luftrave, luftëtarët e veçanërisht të rënë në fushën e nderit dëshmorë, por edhe të pushkatuarit,



SAEDIN SHERIF HAZIZI  
1898-18.02.1944




DALAN MEHMET KAMBERAJ (1893 - 16.4.1943)



PESARE XHEZO KËRROÇAJ  
1906 - 30.1.1944



SHAHO BARJAM SELIMAJ  
1890 - 28.1.1944



BEQIR HASHO OSMANI  
1898 - 28.1.1944



AVDYLL HASHO OSMANI  
1910-28.1.1944

të arrestuarit, burgosurit, që provuan torturat çnjëzore fashiste dhe u shuan nga plagët e burgjeve. Prandaj objekti i kërkimit dhe hulumtimit nëpër rrenjët e historikut të fshatit Vajzë ka pikërisht të rënë në betejë e veçanërisht ata që u pushkatuan pa gjyq se ishin mbështetës të një kauze

të madhe antifashiste shqiptare. Ndërkohë që sipas historikut, çeta partizanë do quhej me ata që emërtoheshin “ushtarë të popullit”. Luftëtarët ishin: Laze Sulejman Hoxhaj, Gani Mystehaj Sulçaj, Riza Çize Brahimaj, Çize Hamit Elezaj, Sinan Alem Nazaj, Fejzi Sherif Sherifaj, Piro Rexhep Hoxhaj, Mustafa

Bellaj, Kadri Gega, Jonuz Karemani, Hate Durmishi, Tafil Telo Sadushaj, Haxhi Mulla Hanaj, Iljaz Zagoll Bilbilaj, Axhem Habib Veselaj, Xhipe Mersin Kapaj, Refat Hyso Kasaj, Xhevdet Hyso Kasaj, Bajram Sali Ajazi, Hysen Sadik Brahimaj, Rexhep Xhevit Shakaj, Teki Mezin Hanaj, Sheremet Çerçiz Demiraj, Arap Arshiu, Rustem Rrapo Ahmetaj, Reiz Ali Xhezo, Shamet Haxhen Hanaj, Zini Rexhep Hoxhaj, Shahin Azem Bellaj, Ali Xhezo Brahaj, Skëndo Zigur Hametaj, Beg Goxho Hanaj, Maliq Hadër Habilaj, Kamo Tare Sheremeti, Taip Belul Hitaj, si dhe 6 të rinj: Qëndro Sadush Bellaj, Maliq Telo Sadushi, Reshat Zagoll Bilbilaj, Mete Mystehak Sulçaj, Bajram Haxhi Hanaj, Remzi Sherifaj.

Bazuar në “Historiku i fshatit vajzë (Vlorë), Vajzë, më 11.1.1981”, gjatë periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare 1939-1944 nga fshati Vajzë i Vlorës kanë rënë njëzetedy partizanë, të cilët janë shpallur “Dëshmorë të Atdheut” dhe më konkretisht: 1.Perlat Rexhepi (hero dhe dëshmor), 2.Sadik Karafili, 3.Rexhep Shakaj, 4.Teki Hanaj, 5.Lelo Hadër Habilaj, 6.Maliq Hadër Habilaj, 7.Isa Veselaj, 8.Mete Sulçaj, 9.Qëndro Bellaj, 10.Mustafa Bellaj, 11.Fehta Resulaj, 12.Gani Resulaj, 13.Faik Shakaj, 14.Haxhi Deraj, 15.Fehti Bora, 16.Axhem Veselaj, 17.Hasan Zenelaj, 18.Zihni Rexhepi, 19.Jetulla Kapaj, 20.Refat Kacaj, 21.Jonus Karemani, 22.Sheremet Çausaj. Ata mbeten krenari e fshatit, krahinës dhe mbarë shqiptarizmit. Por të dokumentuar qartë në historikun e këtij fshati gjëjmë edhe bijtë e bijat e këtij fshati të pushkatuar, që sikurse thotë Maliq Sadushi në librin “Fshati ynë i mirë”, i vitit 2002, faqe 271-272, “Okupatori nazifashist në bashkëpunim me tradhëtarët në çdo operacion që ndërmoi bërë terror në popull. pushkatuan gra e fëmijë..krime të tilla u bënë edhe në Vajzë duke pushtuar pa gjyq nëntë vetë, midis tyre edhe dy gra. Po të merret parasysh aktiviteti i këtyre viktimave në dobi të luftës dhe mënyra se si janë kapur nga armiku, qëndresa e tyre, ata me të drejtë duhen quajtur “Dëshmorë të LANÇ-it”. Kështu që nëpër rreshtat e Historikut të fshatit Vajzë gjatë LANÇ-it (1939-1944), janë të evidentuar edhe këta vajzotë dhe vajzote të pushkatuar nga fashistët italianë e gjermanë si dhe Azbi Nurçe Hitaj, i cili u burgos, u torturua, u gjymtua nga fashistët egërsisht dhe vdiq nga plagët e marra në burgjet e fashizmit. Një përshkrim rigoroz, sipas përshkrimit, kemi shkëputur nga historiku i fshatit Vajzë:

Ferik Zagoll Bilbilaj, ishte në moshë fare i ri kur filloi Lufta Nacionalçlirimtare. E gjithë familja e tij u lidh me luftën. Babai i tij Zagolli, ishte anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar. Vëllai i tij më i madh, Iljazi, qe partizan në çetën e fshatit. Feriku ishte 13 vjeç. Edhe ai punonte, bënte detyrën e korrierit në shumë raste. Në muajin nëntor të vitit 1943 u vra nga forcat gjermane në afërsi të Mullirit të Rexhepit kur po ikte për t'i shpëtuar kapjes nga ana e fashistëve. (sipas origjinalit fq. 142 dhe 143 e Historikut të fshatit Vajzë).

Dalan Mehmet Kamberaj, - ishte një njeri siç e quanin atëhere, që nuk përzihej me politikë. Në fakt Dalani qëndronte neutral. Lëvizjes Nacionalçlirimtare nuk i kishte sjellë ndonjë dëm, merrej më shumë me problemet e shtëpisë së tij. U kap nga forcat italiane në Ashamir

(Vijon në faqen 13)

## AKTUALITET

# Bashkëpunim shembullor mes veteranëve të LANÇ dhe intelektualëve të Gjakovës

**K**a disa vjet që është vendosur një bashkëpunimi shembullor mes Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Shoqatës të intelektualëve “Jakova” nga Gjakova.

Objekt i këtij bashkëpunimi ka qenë koordinimi i veprimtarive të përbashkëta në funksion të përkujtimin të ngjarjeve kryesore të luftimeve për liri e pavarësi të popullit shqiptar dhe përkujtimi I heronjve e dëshmorëve të kombit tone.

Ditë më parë anëtarët e Kryesisë së Shoqatës së Intelektualëve “Jakova” në Gjakovë, kanë pritur në një takim përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare –dega në Gjakovë. Temë e këtij takimi ka qenë “ Shtatorja e Heroit të Popullit, Fadil Hoxha”. Nga diskutimi përmbajtësor doli përfundimi se duhet të bëhen përpjekje të parreshtura për realizimin e kësaj shtatoreje në kuadër të shënimit të vitit jubilar të 80 Vjetorit të Konferencës së Bujanit. U miratua si i qëlluar propozimi që Shtatorja e Heroit të zënë vend në Parkun e Qytetit në afërsi të Pallatit të Kulturës.

va” në Gjakovë, kanë pritur në një takim përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare –dega në Gjakovë. Temë e këtij takimi ka qenë “ Shtatorja e Heroit të Popullit, Fadil Hoxha”. Nga diskutimi përmbajtësor doli përfundimi se duhet të bëhen përpjekje të parreshtura për realizimin e kësaj shtatoreje në kuadër të shënimit të vitit jubilar të 80 Vjetorit të Konferencës së Bujanit. U miratua si i qëlluar propozimi që Shtatorja e Heroit të zënë vend në Parkun e Qytetit në afërsi të Pallatit të Kulturës.



## In Memoriam

## MUSA DOBRUNA (1931-2023)



**N**ë moshën 92 vjeçare ndërroi jetë veterani i Lëvizjes antifashiste Nacionalçlirimtare, antar i Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, dhe patrioti i çështjes kombëtare Musa Dobruna. Gjatë gjithë jetës Musa Dobruna punoi si mësues edukoi, arsimoi shumë gjenerata, kontribuoi për çështjen kombëtare. Ai i takonte familjes atdhetare që është emblem e qytetit të Gjakovës. Antarët e familjes Dobruna me dekada janë gjendur në burxhet e Jugosllavisë vetëm se donin lirin e vendit të tyre. Antarët e kësaj familjeje ishin pjesë dhe ushëheqës në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, madje shumë prej tyre ishin ushtar të luftës së UÇK-së.

Duke folur në ceremoninë e varrimit, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, Zija Mulhaxha tha: “vdekja e Musa Dobrunës është një humbje e madhe për familjen e tij, miqët e shokët e shumë. Një humbje dhe dhimbje e madhe për të gjithë ata që e kemi njohur gjatë e veçanarisht për ne që punuam bashkë në Kryesinë e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në Federatë Shqiptare për Liri dhe Pavarësi” tha veç tjerash kryetari Mulhaxha. Ndërkaq, Dr. Alban Dobruna nga Instituti i Historisë së Kosovës tha “Musa Dobruna ishte një person vërtetë shembullor, një qytetari i sinqert i vendit. Si të tillë do ta kujtojmë gjithmonë”

# GJAK SHQIPTARI RRËZË BEUNIT NË FSHATIN VAJZË

(Vijon nga faja 12)

së bashku me Xhafer Mehmetin në 15 Mars të vitit 1943. Italianët po bisedonin për ti pushkatuar që të dy. Xhaferi që kuptonte italisht pasi e mori vesh se do të pushkatohej, u iku italianëve nga duart dhe u largua me vrap në drejtim të përroit të Zogës, kurse Dalani nuk u largua. Atëherë fashistët e pushkatuan Dalanin menjëherë. (sipas origjinalit fq. 142 e Historikut të fshatit Vajzë).

Këze Sulçaj, nëna e dëshmorëve Mete e Delo Mystehak Sulçaj, u vra nga nazistët gjermanë në afërsi të shtëpisë së saj në dhjetor të vitit 1943. Ajo kudesaj shumë për partizanët dhe me çka i ndodhej i ushqente. Të dy djemtë e saj ishin në luftë. Ajo gjithçka e kishte vënë në shërbim të luftës. (sipas origjinalit fq. 141 e Historikut të fshatit Vajzë).

Pesare Xhezo Kërroçaj, - një grua fshatare e varfër. Me sa mundësi që kishte dhe me çfarë i ndodhej në shtëpinë e saj të varfër, jepte edhe ajo kontributin e saj për luftën. Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre e kapën Pesaren duke u larguar nga një kasolle dhe e pushkatuan me preteksin se ajo ndihmonte partizanët me ushqime, strehime etj. (sipas origjinalit fq. 143 e Historikut të fshatit Vajzë).

Beqir Hasho Osmani, - fshatar i varfër, i lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe ndihmonte me çkishte mundësi. Ishte në moshë të kaluar. U

vra në të njëjtën ditë dhe po nga e njëjta patrullë gjermane që vrau dhe Shaho Selimaj. Beqiri tentoi të ikte nga kasollja e tij që e kishte nën xhade afër ullinjve të Ymerajve, kur forcat gjermane me makina po udhëtonin nga guri i rënë në drejtim të fshatit. Patrulla gjermane e diktoi lëvizjen e tij, hapi zjarr dhe e la të vvarë. (sipas origjinalit fq. 141 dhe 142 e Historikut të fshatit Vajzë).

Abdyl Hasho Osmani, - vëllai i Beqir Osmanit, edhe ky sikurse i vëllai ishte i lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe ndihmonte me sa kishte mundësi. Në janar të vitit 1944 u kap nga forcat gjermane afër përroit të Amonicës, shkante për të njoftuar njësitin që ishte në Amonicë, “se në fshatin e Vajzës dhe në kodrat përfaqë po vendoseshin forcat gjermane..”. Pasi u kap nga forcat gjermane, refuzoi t’u tregonte se ku ndodheshin partizanët. Pas kësaj nazistët e pushkatuan në vend. (sipas origjinalit fq. 142 e Historikut të fshatit Vajzë).

Shaho Barjam Selimaj, ishte burrë plak, me profesion kovaç, në fshatin Vajzë, ishte shumë i varfër dhe pa asnjë ndihmë në familje. U vra nga një patrullë gjermane në rrugën automobilistike afër Kroit të Kovaçit në nëntor të vitit 1943, në tentativën e tij për t’u larguar nga fshati në kohën që vinte një kolonë gjermane nga drejtimi Sevaster - Vajzë. (sipas origjinalit fq. 141

e Historikut të fshatit Vajzë).

Delo Mystehak Sulçaj, djali i Këzes dhe vëllai i dëshmorit Mete Sulçaj; ishte fare i ri në moshë, akoma nuk i kishte mbushur të 14 vjetët, kur në një natë nëntori të vitit 1943, u kap nga gjermanët dhe u pushkatua në afërsi të buzës së bletës. Ai mbajti qëndrim prej burri përpara xhelatëve fashistë, dhe nuk tregoi asnjë nga bazat, as shokët e fshatarët se ku ndodheshin. (sipas origjinalit fq. 140 e Historikut të fshatit Vajzë).

Sadedin Sherif Hazizi, lindur në Vajzë më 1898, në një familje të varfër fshatare. Sadedini e simpatizonte Luftën Nacionalçlirimtare, ndihmonte me çka kishte mundësi. Vëllai i tij Shefit Hazizi, ish-luftëtar i 1920, u plagos në luftën e Vlorës. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare fatmirësisht Hazizaj mbajti qëndrim të mirë. Gjithashu edhe pas luftës kanë mbajtur dhe mbajnë qëndrim të mirë. Sadedini u kap nga pushtuesit gjermanë në muajin shkurt 1944, duke qenë i sëmurë dhe u pushkatua prej nazistëve si aktivist i Luftës Nacionalçlirimtare. (sipas origjinalit fq.143 e Historikut të fshatit Vajzë).

Azbi Nurçe Hitaj, lindur në Vajzë më 1900. Simpatizonte që në fillim Luftën Nacionalçlirimtare, dhe u lidh pazgjidhshmërisht me Frontin Nacionalçlirimtar ndihmonte me çka

kishte mundësi. Në shtëpinë e tij e krijua Këshilli Antifashist dhe ai ishte anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të fshatit Vajzë. Për këtë u arrestua më 16.4.1943, u burgos dhe torturua në mënyrë çnjerëzore duke i shkaktuar plagë të rënda në trup si dhe goditje psikike. Ka vdekur nga torturat e gjymtimi fizik që i bënë në burgje fashistët më 10.2.1945. Që të gjithë kishin rrënjë të thella trashëgimie patriotike e luftëtare nëpër shekuj në mbrojtje të truallit arbëror. Ata ishin krenar për gjakun shqiptar dhe nuk e kursyen atë për ta vënë me koshiençë të plotë në themelet e lirisë. Burimet e studimit: Historiku i fshatit vajzë (Vlorë), Vajzë, më 11.1.1981, faqe 89, 140-143.; Maliq Sadushi, “Fshati ynë i mirë”, Tiranë, 2002, faqe 271-272; Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, Vëllimi i parë, Tiranë, 1984, faqe 284; Perlat Rexhepi Hero i popullit, Tiranë 2002; Revista Pavdekësia, Edhe të rënë në LANÇ, të fshatit Vajzë të shpallen dëshmorë, Nr 4 (148) Gusht 2023; Gazeta Labëria: “Dëshmorët e fshatit Vajzë, nderi i Labërisë dhe gjithë Shqipërisë” faqe 12 dhe 13 Gusht 2023; Gazeta Kushtrim Brezash, Martirët e fshatit Vajzë, Nr 26 (1584) datë 14 korrik 2023; Gazeta “Veterani”, nr 7 (421) korrik 2023: “Gjaku i dëshmorëve të fshatit Vajzë në themelet e lirisë” etj.

## MONOGRAFIA

# BIBË KAZA: GJIN SHURBI, ETALON I NËPUNËSIT TË ADHURUAR



## GJIN SHURBI ETALON I NËPUNËSIT TË ADHURUAR

Nga Halil RAMA-Mjeshtër i Madh

Gazetari, studjuesi e avokati i mirënjohur Bibë Kaza sjell për lexuesin një libër monografik interesant për personalitetin e Mirditës Gjin Shurbi. Në mënyrë kronologjike lexuesi gjen në këtë libër, mbresa, konsiderata, rrëfime dhe analiza për figurën, punën dhe vlerat e Gjin Preng Shurbit.

Që në kopertinën e librit "GJIN SHURBI, ETALON I NËPUNËSIT TË ADHURUAR", lexuesi kupton se monografia i kushtohet një personaliteti që për vite e dekada shërbeu me ndershmëri, vizion e përkushtim në institucione e sektorë të rëndësishëm.

Bibë Kaza na e sjell atë pas një pune të thellë studimore, në gjashtë pjesë, me lëndë të pasur e tematikë të larmishme.

Kështu, nëse në pjesën e parë mësojmë një historik të shkurtër mbi shurbajt në Shebe, gjenealogjinë dhe përshkrimin brilant të kullës unike-simbol qëndrese, në pjesën e dytë përshkruhet hollësisht familja e madhe e personazhit të këtij libri.

Referuar studimit të Prof. Aleksandër Meksit "Ipushkvia Arbanese dhe Principata e Arbërit", botuar në gazetën "Mirdita", Korrik 2015, autori shkruan se "Prindërit, ndoshta jo rastësisht zgjodhën ta pagëzojnë Gjin, që përveçse emër shenjt, tradicionalisht ishte një emër nderi, më së paku qysh nga Gjini – emri i të cilit u përjetësua me Dukagjinin plot shkëlqim në histori, si dinasti disashekullore dhe territor, apo edhe më herët nga Gjini (1199-1207), i biri Progonit, nën sundimin, apo në zotërimet e të cilit kishin qenë dikur edhe trojet ku lindi Gjini i monografisë sonë dhe treva e Kthellës, krahas trevave në mes dy Fanëve lumenj dhe vendbanimet e



Çifti Gjela dhe Gjin P. Shurbi

tjera deri në lumin Mat". (Fq.33).

Dhe pikërisht Gjini (i kësaj monografie) do të ishte mishëruesi dhe përçuesi i vlerave më të mira të familjes së tij, për të cilin siç shkruan autori B.Kaza, "përveçse si mësues pasionant model, spikati edhe si veprimtar shoqëror, aq sa edhe politik, i angazhuar me rininë në aksione e veprimtari të larmishme, si dhe në dobi të mbarë komuniteteve ku shërbeu".

Nderi dhe krenaria e fisit dhe familjes së tij emërndritur do të ishte Gjini në të gjitha funksionet drejtuese në rrethin e Mirditës, ku ndonëse kalemxinjtë mediokër të kohës apo të ndonjë klani a partiaku të lartë të molepsur në rreth, do përpiqeshin ta pengonin me çdo kusht e mjet, ai do t'i sfidonte ata me ndershmërinë, përkushtimin dhe vizionin bashkohor në detyra e funksione të rëndësishme. Kështu ai kreu më së miri funksione e detyra si: Drejtor i Kooperativës së Konsumit Rrëshen, që më pas u quajt Ndërmarrja Tregtare (1960-1962), Shef i Organizimit dhe Sekretar i Komitetit të Partisë të rrethit e njëherësh edhe Sekretari i Komitetit të Partisë të Ndërmarrjes Minerare në Rubik (1962-1965); Kryetar i Bashkimeve Profesionale (1968-1975); Drejtor i Ndërmarrjes Gjeologjike të rrethit Mirditë (1975-1978); Drejtor i Parkut të Mallrave në Mirditë, detyrë që e kreu gjatë tre viteve (1978-1982); Kryetar i Këshillit Popullor të qytetit Rrëshen (1982-1986); Përgjegjës i Seksionit të Punës në Komitetin Ekzekutiv Mirditë, (1986-1988); Përgjegjës i Seksionit të Kuadrit në Komitetin Ekzekutiv Mirditë, detyrë që e kreu deri me datën 17.11.1991, kur Gjin Shurbi doli në pension të parakohshëm, me kërkesë të tij.

### DIMENSIONI NJERËZOR DHE POTENCIALI INTELEKTUAL I GJIN SHURBIT

Në kapitujt e tretë dhe të katërt, autori i kësaj monografie ofron një spektër të gjerë të informacioneve, fakteve e detajeve deri më tani të panjohura, të personalitetit të Gjin Shurbit. Dhe këtu ai nuk sjell thejeshtë mendimin e tij por vlerësime të bashkohësve për personalitetin e Gjin Shurbit. Janë këto mbresa, rrëfime, konsiderata autentike si dhe fjalë zemre nga të afërmit që ndriçojnë peshën e mendimit, dimensionin njerëzor, potencialin intelektual dhe shpirtin krijues, humanizmin dhe sakrificat e këtij personaliteti të shquar të Mirditës e gjithë Shqipërisë. Kështu, nëse Mark Tirta e konsideron personazhin e kësaj monografie veprimtar të shquar, nder i Mirditës; Petraç Kalemi, bashkëpunor fisnik dhe mik të vërtetë; Gjon Bushpepa, ish-sekretar i Komitetit të Partisë së Rrethit Mirditë, njeri të punës, sakrificës dhe fjalës së mbajtur; shkrimtari Pjetër Nikolli burrë të spikatur vlerash; Nikoll Brozi një shembull të vlefshëm për brezat, ish-ministri i Industrisë Viktor Doda, vlerëson aktin e dorëheqjes nga Gjin Shurbi që sipas tij "jepet jo vetëm kur përgjegjësia bie mbi ty".

Dhe jo vetëm këta, por edhe 15 personalitetet të njohura mirditore bëhen pjesë e këtij libri me opinionet e vlerësimet për bashkohësin e tyre që frymëzon dhe do të frymëzojë brezat.


Ilustrimi me foto të shumta, dokumentat arkivore, mbresat, përshtypjet dhe ndonjë poezi në kapitullin e pestë (In memoriam) e bëjnë më të këndshëm e tërheqës këtë monografi.

Prandaj edhe Gjovalin Ndoja (në parathënie) e vlerëson këtë libër, aktual në përmbajtjen e tij, prapavijë e një historie suksesi që na duhet për të krahasuar nëpunësit e lirisë, që të rrjepin edhe "kockën e fundit", me idealistët e sistemit të përmbytur, që dolën në pension të pashpërblyer, por aspak të penduar në ndershmërinë e tyre...

### MODEL I DINJITARIT, DERI NË LARGIMIN NGA JETA

Publicisti, shkrimtari dhe avokati Bibë Kaza, në këtë monografi, qartë ka ngërthyer plotësinë e përmasave kombëtare, njerëzore, politike dhe morale të Gjin Shurbit, të atij që për tridhjetëshestatë një vjet identifikohet si drejtues partiak e shtetëror shembullor, ndryshe nga shumë të tjerë burokratë mediokër të asaj kohe. Ndaj dhe me të drejtë autori Kaza shkruan se : "...imazhi i Gjin Shurbit - model i dinjitarit deri edhe në largimin nga jeta, as at'herë në të ngrysur të jetës dhe as pas kalimit në amshim, nuk kishte kurrfarë nevojë për larje a lyerje, kurim a meremetim fiktiv, assesi për elozhe, kompensim a nderime të munguara, anipse gjithë jetës Ai i'u përkushtua më të mirës së përbashkët, duke merituar pandërprerë nderime, por shpërfillës që të rend pas tyre, apo rrahë gjoksin". Për Bibë Kazën, ajo ç'ka lypsej të shkruhej ishte vetëm një përfytyrim a pasqyrim sa më besnik i shembëlltës së tij, si një testament moral jetësor për brezat, më së paku familjar...(fq.167-168). Kësisoj, autori Kaza, është tejet bindës dhe objektiv në shkrimin e monografisë "GJIN SHURBI, ETALON I NËPUNËSIT TË ADHURUAR". Mjafton për këtë qoftë edhe dokumentacioni zyrtar dhe arkivor që përbën pjesën e gjashtë të librit. Po në këtë pjesë lexuesi njihet me rendin kronologjik të detyrave të kryera nga Gjin Shurbi; Medaljet dhe Urdhërat që i janë arkorduar atij, (Por, edhe masat ndëshkimore) si dhe Disa kujtime të fiksuara në celuloid.

...



• Në këtë monografi, autori B.Kaza ka ndriçuar me mjeshtri, jo vetëm historikun e një prej familjeve më në zë nga Shurbajt e vendosur në Shebe, si një ndër katundet me emër dhe me jehonë në histori, në periferi të trevës së Kthellës historike të Mirditës, që me kohën u mëkëmbën dhe u shtuan, por edhe personalitetin e shquar të kësaj familje, Gjin Shurbi

## NGJARJA

Përkujtimi i 11 shtatorit tashmë është kthyer në traditë e vlerë historike nga Bashkia në Bronx

# Kur do të marrë fund terrorizmi?

Nga Mimoza Dajçi

Kaluan 22 vite dhe çdo qytetar në SHBA kujton me dhimbje 11 Shtatorin e vitit 2001, si dhe viktimat në njerëz që humbën jetën gjatë asaj tragjedie, kur terroristët islamikë rrëmbyen avionët dhe përflakën hapësirën amerikane duke goditur Pentagonin dhe World Trade Center.

Çdo kush që e do jetën lirinë, paqen pyet me të drejtë: Kur do të marrë fund terrorizmi?

Edhe unë si dëshmitare okulare e asaj ngjarje që tronditi botën, bashkohem me dhimbjen e madhe që shkaktoi ajo katastrofë, e njëherësh nëpërmjet këtij shkrimi, hedh dritë mbi një fakt që deri më sot nuk e kam lexuar në faqet e shtypit shqiptar.

Së pari po ndalem tek Ceremonia Përkujtimore që organizoi për të dytin vit Presidentja e Bashkisë në Bronx Vanessa Gibson me qytetarët, politikanët dhe organizatat e ndryshme jo qeveritare në nderim të afro 3000 heronjve që humbën jetën gjatë atij sulmi terrorist. Tubimi u mbajt më datë 13 shtator 2023 pranë Bashkisë në Bronx, nën moderimin e drejtorit të Teatrit për Fëmjië në Riverdale Derek Woods. Si fillim u mbajt një minutë heshtje, më pas "Hymni Amerikan" u këndua nga sopranoja Diane Arroya, lutjet fetare u mbajtën nga Kleri katolik, mysliman etj dhe nga Rabbai i Institutit hebre në Riverdale. Banda frymore "Pipes & Drums" e shtetit të New Yorkut ekzekutoi muzikë të zgjedhur si homazh për të rënë të 11 shtatorit 2001.

Fjala e hapjes ju rezervua Presidentes së Bashkisë në Bronx Vanessa Gibson, eventin gjithashtu e përshëndetën gjykatësja supreme e Gjykatës Civile në Bronx Hon. Doris Gonzales, politikanë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Një ftesë për këtë ceremoni mbërriti edhe në postën time elektronike, ku pata rast të takohem me Presidenten Vanessa Gibson, nëpunësen e lartë të Bashkisë në Bronx Cecilia Hernandez,



Anëtares e Këshillit Bashkiak të New Yorkut Pierina Sanchez etj.

\*\*\*

Mëngjesin e datës 11 Shtator 2001 ndodhesha brenda Trenit Nr. 4 kur u shemb tyneli Chamber Street në Manhattan, New York, pas kolapsit që ju bë dy kullave binjake të World Trade Center nga bombardimi i dy avionëve rrëmbyer nga terroristët. Nga shembja e tynelit rruga e trenit Nr. 4 për në Brooklyn ishte bllokuar, treni nuk udhëtonte dot më tej. Paniku i madh pushtoi frymën dhe zemrat e pasagjerëve, të cilëve po i rrezikohej jeta.... Unë ishta nisur nga rruga Jerome Av-

enue në Bronx, adresë ku jetoja atë kohë për të shkuar drejt Brooklynit.

Pak muaj kisha në SHBA, e sapo kisha fituar statusin si azilante politike, dhe si e papunë mu aprovua ndihma ekonomike, por për të përfunduar këtë proces duhej të jepja edhe shenjën e gishtave. Kështu më 11 shtator 2001 u nisa për një takim në Brooklyn, në Zyrën e ndihmës ekonomike për shenjën e gishtave për të përfunduar e përfutuar kështu ndihmën ekonomike. Takimi ishte në ora 10 AM. Pas asaj tragjedie zyrat në Brooklyn ishin mbyllur dhe nuk munda të takoja asnjë nga punonjësit e atij institucioni. Situata ishte jashtë kontrollit, tepër e rënduar

## Ky është globi që rrotullohet

Mimoza Dajçi

*Kur fëmija lind,  
bota gëzohet  
Kur rritet vajza,  
martohet.  
Kur djemtë thinjen,  
burrërohen.  
Kur gratë plaken,  
zemërohen.  
Kur njerëzit vdesin,  
"harrohen".  
Kur uji rrjedh,  
lumi pastrohet.  
Kur nata vjen,  
dielli largohet.  
Ky është globi,  
që rrotullohet.*

si gjendje lufte dhe askush nuk ishte në zyrë atë moment. Ashtu siç isha e traumatizuar e pluhurosur me tym e pluhura nga shpërthimet e dy kullave, e dërmuar shpirtërisht, fizikisht e mendërisht arrita të gjej ku ishte Zyra e Ndhmës ekonomike në Brooklyn, por asnjë nëpunës nuk ndodhej aty. Rashtësisht pyeta një punonjës policie, ai më tha: Jo moj zonjë këtu nuk punon askush pas kësaj tragjedie.

Për çudi pas disa ditësh më vjen një letër nga Zyra e Ndhmës ekonomike në Brooklyn në banesën e atëhershme në Bronx, ku shkruhej se kisha humbur përfitimin e ndihmës ekonomike, pasi nuk isha paraqitur në takim për shenjën e gishtave në Brooklyn më datë 11 shtator 2001, ora 10 AM. Ndhmën ekonomike arrita ta fitoj pasi këtë çështje e paraqita në gjykatë, pasi që ishte e vërtetë që atë ditë kisha udhëtuar nga Bronx në Brooklyn, për tek zyrat e ndihmës ekonomike, pasi isha pa punë, pa asnjë të ardhur ekonomike dhe nuk kisha me se të paguaja qeranë e garsonierës në Bronx. Këtë histori e kam publikuar më të zgjeruar e titulluar "Kur do të marrë fund terrorizmi" edhe në librin "Nënës" në vitin 2007 nga "Bota e Gruas Shqiptare" në Amerikë. E kam pas dërguar për botim edhe në anglisht tek gazeta "New York Times" por nuk kam dijeni nëse është botuar apo jo. Pra prezencën time më datë 11 shtator 2001 e kam bërë të njohur për opinionin publik qysh atë kohë. Përkujtimi i 9/11/2001 tashmë është kthyer në traditë e vlerë historike nga Bashkia në Bronx edhe për brezat e rinj, ku mes viktimave që humbën jetën në krye të detyrës ishin edhe tre shqiptaro - amerikanët Mon Gjonbalaj, Roko Camaj dhe i riu Simon Dedevekaj, të cilët punonin si mirëmbajtës tek Kullat Binjake 110 katëshe në Manhattan.

Presidentja e Bashkisë në Bronx Znj. Gibson pasi falenderoi organizatorët e kësaj ceremonie, forcat e rendit dhe të pranishmit në sallë i ftoi të gjithë pjesëmarrësit në koktejin e shtruar enkas për këtë event.

## BIBË KAZA: GJIN SHURBI, ETALON I NËPUNËSIT TË ADHURUAR

(Vijon nga faqja 14)

Në këtë monografi, autori B.Kaza ka ndriçuar me mjeshtri, jo vetëm historikun e një prej familjeve më në zë nga Shurbajt e vendosur në Shebe, si një ndër katundet me emër dhe me jehonë në histori, në periferi të trevës së Kthellës historike të Mirditës, që me kohën u mëkëmbën dhe u shtuan, por edhe personalitetin e shquar të kësaj familje, Gjin Shurbi.

### PAK RADHË PËR AUTORIN BIBË KAZA

Ka lindur më 20.05.1958 në Mashtërkor, Orosh, Mirditë. Pas marrjes së dijeve të para në vendlindje, mbaroi Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" dhe në vazhdim Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, duke mbrojtur diplomën me notë maksimale dhe titulluar oficer xhenier në vitin 1981. Gjithashtu, pa shkëputje nga puna, ka mbaruar studimet në Shkollën e Lartë "V. I. Lenin" më 1988, si dhe fakultetin Juridik të UT, duke u titulluar jurist më 1996. Më pas fitoi titullin "Avokat" më 2003 dhe "Avokat

Shteti" më 2010, si dhe është specializuar për të Drejtën Ushtarake në New Port RI, SHBA gjatë vitit 1989. Pas titullimit oficer aktiv, deri në vitin 1987 shërbeu në detyra dhe struktura të ndryshme ushtarake në rrethet Skrapar, Pukë e Tiranë. I aktivizuar paraprakisht si bashkëpunor shtypi, nga marsi 1987, për gjashtë vjet punoi redaktor e gazetar në Gazetën "Luftëtari" dhe "Ushtria dhe Koha". Nga viti 1992 deri në 2004, kur përmbylli me nder karrierën ushtarake me gradën "Kolonel", shërbeu në detyra të ndryshme, si specialist ushtarak e nëpunës civil, audit i brendshëm, shef sektori dhe drejtues i Degës Juridike të Ministrisë së Mbrojtjes. Më pas kaloi shef sektori juridik në DSHTD të Ministrisë Jashtme, kurse gjatë viteve 2010 - 2017, punoi si Avokat Shteti, Ministria e Drejtësisë, duke suksesuar kësodore në një sërë detyrash dhe institucionesh ku ka punuar. Veç publicistikes, si pasion vazhdues, ka botuar artikuj profesional e studimor, kryesisht në fushën e të Drejtës Kushtetuese e Ushtarake, si dhe botime të karakterit të mbrojtjes në grupe autorësh. Për përkushtimin dhe performancën në punë është dekoruar nga Presidiumi i KP, si individ, sikurse edhe nënreparti që drejtonte si komisar, më 1986.

## MUZEU

Batalioni i Dytë i UÇK-së “RUZHDI SALIHU” dhe Komandanti RAMIZ QERIQI- “LUANI”

# Nuk mund të ndërtojmë të ardhmen nëse nuk nderojmë të kaluarën

Nga Maksim Vinçani, Nënkrjetar i OBVL

Mbas një korespondence midis nesh, arritëm të njihemi nga afër me Z.Ramiz Qeriqi ose Luani - pseudonimi i tij gjatë Luftës së UÇK. Ishte kënaqësi e veçantë të bisedoje me Luanin, ish - komandantin legjendar të Batalionit të Dytë heroik të UÇK-së, “Ruzhdi Salihu”. me këtë njeri kaq të thjeshtë dhe modest, njëherësh një legjendë e vërtetë. Atë natë kur u njohëm nga afër, i ftuar në shtëpinë time në Elbasan, pothuajse e gdhimë duke folur, ku mësova nga goja e tij për shumë e shumë gjëra që më lanë përshtypje të thella...

**Po cili është Ramiz Qeriqi - Luani, Batalioni Dytë “Ruzhdi Salihu” dhe nga se u emërtua kështu ky batalion?**

Ramiz Qeriqi jo vetëm është një personalitet i Luftës Çlirimtare të Kosovës, por edhe në këto kohët e Lirisë vazhdon të jetë një qytetar aktiv në jetën politike - shoqërore - qeverisëse, përherë objektiv në qëndrimet e tij vlerësuese ose kritikuese. Po ashtu, si një atdhetar e veteran i luftës, nuk ka pushuar asnjëherë veprimtarinë e tij në shërbim të kujtesës historike të ngjarjeve dhe të figurave patriotike të vjetra e të reja. Ai është promotor dhe organizatori kryesor i formimit



të muzeut të Luftës së UÇK, ku në një ceremoni të denjë u kujtua 25-vjetori i themelimit të Kazermsë së Parë Ushtarake të batalionit të dytë “Ruzhdi Salihu” në Pjetërshicë të Komunës së Lipjanit, i vizitave në familjet e luftëtarëve që ranë për Lirinë e Kosovës, i përkujtimit të ngjarjeve të rëndësishme me karakter kombëtar dhe lokal. Karakterizohet nga një atdashedashuri e madhe. Moton e tij e shpreh duke adaptuar fjalët e Ismet Munishit: “Ne e kemi nanë Shqipërinë dhe dashuria për nanën është pa kusht!” Në vijim po i referohem disa pjesëve të kujtimeve apo shkrimeve

nga ditari i Ramiz “Luanit”:

\*\*\* “Dalja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte lajmi më i gëzueshëm për popullin tonë. Inkuadrimi i Ruzhdiut (Ruzhdi Salihut, emri i të cilit iu vu batalionit, sh.im) në UÇK ishte i natyrshëm, për më tepër shtëpia e tij në Zborc u shndërrua në pikën e parë të UÇK-së në fshat. Nga aty u organizuan dhe u kryen aksione të shumëta kundër paramilitarëve serbë. Në krye të detyrës, në mbrojtje të nderit dhe atdheut, Ruzhdiu ra dëshmor, duke lënë pas vetes shembullin e idealistit, atdhetarit dhe luftëtarit të shquar.”

\*\*\* “Ne nuk mund të ndërtojmë të ardhmen, nëse nuk nderojmë të kaluarën. Nuk guxojmë të lejojmë që të harrojmë nga kemi ardhur sepse humbim rrugën edhe për të ardhmen.”

“Në vitin 1993, profesor Maksim (Lisimak Theodhori, i cili ndërroi jetë më 15 Tetor 2021 sh.im) ka stërvitur grupin e djemëve dhe vajzave për luftë guerrile, duke përgatitur me aftësi dhe shkathtësi më të larta ushtarake të kohës për t'i shërbyer me nder e dinjitet flamurit, Atdheut dhe Kombit tonë të bashkuar, Shqipërisë Etnike. Në ushtrime ushtarake kemi qenë dy grupe. Grupi i vajzave që përbëhej nga: Merita Mazreku, Rrushe Gashi, Sanije Geci, Hamide Buçaj dhe Zylfije Bilalli ku përgjegjëse për grupin e vajzave ishte, Merita Mazreku. Kurse grupi i djemëve që përbëhej nga: Ramiz Qeriqi-Luani, Halil Olluri, Dalip Durmishi, Ilaz Dërguti, Ilaz Koci, Hysen Gucati dhe Naim Rizani, ku përgjegjës për grupin e djemëve ishte Ramiz Qeriqi-Luani”...

\*\*\* “Duke qenë njëri ndër antarët e parë të njëjësive guerile të KKBTSH-së, dhe duke mbajtur shënime nga ditari personal i punës që e kam mbajtur në kohën sa kanë zgjatur ushtrimet ushtarake në Shqipëri, e po ashtu edhe procesverbali i mbajtur me rastin e planit të punës që bëheshin gjatë stërvitjeve ushtarake, janë dy dokumente të dorës së parë që dëshmojnë se kur, ku dhe nga kush u krijua baza e themelimit të njëjësive të para guerile, të cilët me formimin e njëjësive të para guerile në vitin 1993, ia vuan themelin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të gjithë kishim pranuar obligime dhe detyra të karakterit ushtarak kombëtar, ku kërkohej nga ne të jemi vigilentë dhe të kemi përgjegjësi në veprime. Këto ushtrime konsiderohet që kanë luajtur rol kryesor për të shërbyer me devotshmëri e përkushtim në detyra e funksione të rëndësishme në organizim, drejtim dhe komandim të njëjësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe kjo përbënte momente kthese në luftën çlirimtare dhe rrjedhën e saj, e me theks të veçantë në Batalionin e Dytë “Ruzhdi Salihu”. duke nxjerr në pah figurat më me peshë që në ditët e para të luftës sonë për liri”...

“Ishte nder për familjen dhe Batalionin e Dytë ‘Ruzhdi Salihu’, pas 24 vitesh, që u vizitua nga një ministër i mbrojtjes. Respekt për ministrin e Mbrojtjes Armend Mehaj nga familjarët dhe nga ish luftëtarët e Batalionit të dytë Ruzhdi Salihu. Aktiviteti më i fundit ishte më 24 Gusht 2023 ku u organizua përkujtimi i përvjetorit të rënies së dëshmorit Gani Kastrati. Në ceremoni ishin të pranishëm dhe Kryetari i Komunës së Shtimjes z. Qemajl Aliu, Deputeti meritor z.Gani Krasniqi dhe Ministri i FSK-së z.Armend Mehaj. Në fjalën e rastit, Ish komandanti i Batalionit të Dytë ‘Ruzhdi Salihu’, zoti Ramiz Qeriqi - Luani vuri në dukje vlerat dhe kontributin luftarak të ish luftëtarit të këtij batalioni, Gani Kastrati. Ai foli për heroizmin e tij në luftën guerile dhe në luftën çlirimtare duke rënë dëshmor. Gjithashtu, Ish Komandanti theksoi se është detyrë patriotike kujtesa e luftimeve të popullit tonë, e figurave udhëheqëse dhe të spikatura, sidomos për ata që ranë për Liri dhe lanë amanetin për Bashkimin Kombëtar.

**Lavdi luftëtarëve heroikë të UÇK! Lavdi të rënëve për Lirinë e Trojeve Shqiptare!**

## Ahmet Cami – Biografi e shkruar me gjak si pjesëmarrës i dy luftrave botërore

(Vijon nga faqja 11)


Skënder Menzelxhiu në botimin e tij “Ditar Partizan” ( Gusht 1944-Maj 1945 )- Tirane 1975 shkruan:“...Trimat partizane s’u tremben as nga plumbat as nga vdekja.

Shoku yne Ahmet Feha Cami nga Viçishti, komandanti trim i rrallë i çetës së Gollobordës, që u bë tmerr për shkelësit dhe tradhëtarët, megjithëse i plagosur rëndë, në pamundësi që të fliste se plumbi gjakatar i kish rrëmbyer e prishur nofullën dhe gojën, me laps e letër në dorë, gjallërisht, me besim të patundur në fitoren tonë, vazhdonte të komunikonte me shokët e tij, jepte pororsira që t’i binin armikut e mos ta linin të qetë derisa të shporresh, shkruante fjalet e tij te fundit “ Te rroje Shqipëria e lire!“(Fl.2)

### LIBRI QË PASURON LETËRSINË TONË DOKUMENTARE

Pas rënies së Ahmetit Çeta Partiazane e Gollborës u inkuadrua në formacionin e Brigadës së 18 S dhe ka kryer edhe shumë luftime të tjera, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Në listën e Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Dibrës, që i dërgohet Presidiumit të Kuvendit



Popullor me 30.1.1984, është shënuar emri i Ahmet Fatah Cami si Dëshmor i Atdheut i shpallur me Vendim Nr. 50 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Dibrës me 30.6.1972.

Ahmet Cami për kontributin e dhënë në Luftën Nacionalçlirimtare, iu akorduan menjëherë Medalja e Kujtimit, Medalja e Trimërisë dhe Medalja e Çlirimit. Ndërsa në vitin 1966 dhe 1967 nga rrethi i Dibrës i është propozuar dy vite rrjesht Presidiumit të Kuvendit Popullorë që Ahmet Camit t’i jepej titulli “Hero i Popullit” për qëndrim patriotik dhe heroik gjatë luftës Nacionalçlirimtare. Por ky titull nuk iu dha, sepse qe cilësuar si nacionalistë nga jugosllavët. Komisioni Qëndror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” me Vendimin Nr.5, datë 27.12.2002, firmosur nga Kryetari i Komisionit dhe Nënkrjetar i Republikës së



Shqipërisë i jepet “Certifikata e Dëshmorit të Atdheut”.

Më i plotë aktiviteti patriotik, luftarak dhe intelektual i tij jepet në librin me 415 faqe (“Ahmet Fatah Cami – Autobiografi e shkruar me gjak nga pjesëmarrësi i dy luftrave botërore”, me bashkautorë djalin dhe vajzën e tij: Moisi dhe Ahmet Cami. Në këtë libër, përveç biografisë së shkurtër dhe ditarit të Ahmet Camit jepet një panoramë mbi historinë e Luftës Nacionalçlirimtare në Dibrë, parë nëpërmjet dokumentave arkivore, mbresa dhe kujtime të të afërmeve dhe bashkëluftëtarëve të Ahmetit, artikuj dhe emisione të bëra në Kujtim të përvjetorëve të rënies së tij; dëshmi dhe fakte, dokumenta arkivore, fotografi e tij. Si i tillë ky libër pasuron dukshëm Historinë e ndritur të LANÇ dhe letërsinë tonë dokumentare.